

Raport Vjetor

2021



2021

Raport Vjetor 2021

MISIONI

Të fuqizojmë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për të mirën e shoqërisë si përfitues i fundit.

VIZIONI

Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.

QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

Anëtare me të drejta të plota në:





20 VJET ShKÇAK.

Këtë vit, përkatësisht me datë 16 maj 2021, ShKÇAK i ka mbushur 20 vjet që nga themelimi i saj në vitin 2001, për të shënuar këtë vit jubilar, Zyra Ekzekutive filloi me aktivitetet e para duke e promovuar përmes rrjeteve sociale.

Përgjatë kësaj periudhe dhe gjithë këtij rrugëtimi SHKÇAK është ballafaquar me sfida të mëdha, por në të njëjtën kohë ka arritur edhe suksese të jashtëzakonshme. Gjithsesi këto suksese janë reflektuar, në radhë të parë në avancimin e profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit, duke zhvilluar dhe përparuar një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar. ShKÇAK tashmë përmbush standardet më të larta profesionale dhe etike, si dhe përmbush performancën organizative përmes Qeverisjes së mirë, menaxhimit financiar, sigurisë dhe ekspertizës së specializuar. Shoqata sot është lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve të tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.

Sot, 20 vjet më pas, ShKÇAK vazhdon me të njëjtin ngulm dhe përkushtim zhvillimin e profesionit dhe rritjen e reputacionit të saj, si e vetmja shoqatë profesionale e Kontabilitetit dhe Auditimit në Kosovë që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA), Federatës Mesdhetare të Kontabilistëve (FCM). Përmes këtyre anëtarësimeve Shoqata përfaqëson zërin e profesionistëve të Kosovës në këto organizata globale, përcaktuese të kriterëve dhe standardeve në fushën e kontabilitetit dhe auditimit dhe luajnë rol aktiv në zhvillimet globale të profesionit.

Fuqia e Shoqatës sonë buron nga anëtarët e saj, angazhimi dhe përkushtimi i tyre për avancimin e profesionit, për çka ShKÇAK është mirënjohëse dhe i falënderon për punën profesionale të dëshmuar për këto 20 vjet ekzistencë. Së bashku do të vazhdojmë edhe më tej në arritjen e synimeve tona për të kontribuar në vazhdimësi në fuqizimin dhe në avancimin e profesionit dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë!

Faleminderit Bordit të Shoqatës për udhëheqjen dhe qeverisjen strategjike, dhe shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë stafin tonë të përkushtuar.

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| 20 vjet ShKÇAK..... | 5 |
| FJALA E KRYETARES..... | 8 |
| MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE..... | 10 |
| AKTIVITETET E SHKÇAK GJATË VITIT 2021..... | 12 |
| DIGJITALIZIMI NE FOKUS TE SHKÇAK..... | 13 |
| Strategjia e zhvillimit të SHKÇAK 2020 – 2024..... | 14 |
| Mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve..... | 16 |
| QEVERISJA E MIRË..... | 18 |
| Mirëmbajtja dhe përditësimi i njohurive përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional..... | 21 |
| Menaxhimi i cilësisë për pajtueshmëri me standarde (MCPS)..... | 22 |
| Programet çertifikuese të ShKÇAK - Organizimi i trajnimeve në mënyrë virtuale..... | 23 |
| AKTIVITETET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE..... | 25 |
| BASHKEPUNIMI RAJONAL..... | 32 |
| ShKÇAK AKTIVE NË SFERËN GLOBALE..... | 34 |
| Bashkëpunimi i ShKÇAK dhe Global DCA..... | 37 |
| Bashkëpunimi i ShKÇAK dhe Cactus Education..... | 39 |
| STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK..... | 40 |
| STUDENTËT E VITIT 2021..... | 41 |
| RAPORTET E KOMISIONEVE..... | 42 |
| RAPORTI NGA KOMISIONI PËR NOMINIME..... | 44 |
| RAPORTI NGA KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË..... | 47 |
| RAPORTI NGA KOMISIONI PËR AUDITORË LIGJOR..... | 50 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR KONTABILISTË TË ÇERTIFIKUAR..... | 52 |
| RAPORT NGA KOMISIONI PËR EDUKIM DHE STANDARDE PROFESIONALE..... | 54 |
| KOMISIONI PËR MENAXHIMIN TË CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET..... | 57 |
| RAPORTI NGA KOMISIONI PËR TATIME..... | 60 |
| TË DHËNA STATISTIKORE 2021..... | 64 |
| Shërbimet që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK-së..... | 64 |
| Studentët e regjistruar gjatë vitit 2021..... | 65 |
| Titujt e fituar përgjatë viteve..... | 66 |
| Programi Auditor i Brendshëm i Çertifikuar..... | 67 |
| Pjesëmarrja në profesion sipas gjinisë..... | 68 |
| Pjesëmarrja në ligjëratat përmes platformës virtuale..... | 69 |
| IN MEMORIAM..... | 70 |

SHKURTESAT

| | |
|-----------|--|
| AAT | Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit të Britanisë së Madhe |
| ACCA | Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë |
| AKK | Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve |
| ATK | Administrata Tatimore e Kosovës |
| BQK | Banka Qendrore e Kosovës |
| CAP | Paneli Këshillues mbi Pajtueshmërinë i FNK |
| CIPFA | Instituti i Licencuar për Financa Publike, Kontabilitet dhe Auditim |
| DOA (SMO) | Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të FNK |
| EFAA | Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM |
| FCM | Federata e Kontabilistëve të Mesdheut |
| FNK | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IEKA | Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar |
| KKRF | Këshilli Kosovar për Raportim Financiar |
| MF | Ministria e Financave |
| NVM | Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme |
| OEAK | Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë |
| OEK | Oda Ekonomike e Kosovës |
| PAODC | Komisioni i FNK për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit |
| PVM | Praktikat e Vogla dhe të Mesme |
| QRRF | Qendra për Reforma në Raportim Financiar |
| SNA | Standardet Ndërkombëtare të Auditimit |
| SNE | Standardet Ndërkombëtare të Edukimit |
| SNK | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit |
| SNRF | Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar |
| ShKÇAK | Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës |
| ZKA | Zyra Kombëtare e Auditimit |



FJALA E KRYETARËS

Shpresa Mustafa

Kryetare e bordit

Të nderuar Anëtarë,

Mandati im dy vjeçar në udhëheqje të ShKÇAK ka qenë mjaft sfidues, duke qenë dëshmitarë dhe të ndikuar drejtëpërdrejtë nga pandemia globale Covid 19. Pasiguria për të ardhmen ekonomike po vazhdon dhe vështirë të parashikohet kthimi në normalitet.

ShKÇAK me 16 Maj 2021 shënojë 20 vjetorin e themelimit të saj. Edhe pse plani ynë ishte të bëjmë një ceremoni festive duke ftuar të gjithë akteret vendor dhe global ashtu siq ShKÇAK e ka traditë të shënojë përvjetorët e saj, pamundësia për t'i bashkuar anëtarët dhe mysafirët fizikisht solli me vete sfida të jashtëzakonshme, ndikimi i COVID-19 tregoi se jemi të obliguar të gjithë të ridizajnojmë proceset dhe rrjedhat e punës.

Ne mbesim me shpresë se në vitin 2022 do të festojmë 20 vjetorin e fillimit të aktiviteteve të Shoqatës, çertifikimeve të para, anëtarëve të parë dhe funksionalizimin e zyrës me kapacitet të plotë.

Kam kënaqësinë që në emër të të gjithë anëtarëve të them se ShKÇAK-ja gjatë këtyre viteve arriti të ecë përpara në shumë nga synimet që kemi vendosur pavarësisht sfidave. Ne kemi demonstruar shkathtësi të jashtëzakonshme në synimet tona për udhëheqje dhe ngritje të profesionit në vendit tonë.

Nuk duhet të harrojmë kurrë faktin se me profesionin tonë ne ndikojmë në publikun e gjerë prandaj duhet të gjithë të fokusohemi në edukim të vazhdueshëm profesional që të jemi të gatshëm t'u përgjigjemi nevojave bashkëkohore të ekonomisë.

Angazhimi ynë i qëndrueshëm dhe performanca e lartë ishte thelbësore për suksesin e Shoqatës gjatë 20 viteve.

Shoqata ka vazhduar të mbështesë qeverisjen e mirë, duke krijuar linja të forta raportimi dhe komunikimi me studentët, anëtarët dhe Bordin e Shoqatës si dhe është angazhuar në drejtim të avokimit për përmisimin dhe avansimin e profesionit sipas standardeve më të avansuara etike dhe profesionale.

Shpreh falenderim për përkushtimin e anëtarëve e Bordit dhe Komisioneve të Shoqatës, e në veçanti Zyrën Ekzekutive për përmbushjen e objektivave të parapara për vitin 2021.

Urime 20 vjetorin!



Anëtarët e Bordit
Nga e majta: Aurora Sinani Dinaj, Burim Cena, Shpresa Mustafa, Teuta Ukshini Aliu, Xhevdet Beqiri dhe Melita Ymeraga.
Mungon: Nazmi Pllana



MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE

Ardiana Bunjaku
Drejtoreshë Ekzekutive

Dy dekada përkushtim. E mahnitshme.

Për 20 vite më radhë, përgjegjësia ka qenë gjithmonë një vlerë e fortë, udhërrëfyese në ShKÇAK.

Detyra jonë që nga fillimi ishte të ndërtojmë një organizatë profesionale, transparente, të qëndrueshme dhe të njohur ndërkombëtarisht.

Ne jemi përpjekur dhe kemi arritur që për 20 vite të ndërtojmë organizatën tonë mbi një themel të integritetit dhe sjelljes etike, me menaxhim të përgjegjshëm dhe të përkushtuar për të demonstruar vazhdimisht standarde të larta etike dhe profesionale.

Ne vazhdojmë të përforcojmë këtë angazhim. Pasioni për përsoshmëri në shërbim është bazë për suksesin tonë, krijojmë vlera afatgjate dhe fitojmë besimin e anëtarëve tanë, studentëve dhe komunitetit në të cilin ne operojmë, duke shikuar nga e ardhmja për të kontribuar në prosperitetin ekonomik dhe mirëqenien sociale.

ShKÇAK ka një histori të gjatë krenare 20 vjeçare të funksionimit në mënyrë të ndershme, parimore dhe të disiplinuar.

Ne do të përmbushim qëllimet tona strategjike, pavarësisht sfidave të mëdha duke përfshirë pengesat e vazhdueshme nga pandemia që vazhdon të ketë një ndikim kaq thelbësor në punën dhe jetën tonë, duke ushtruar presion edhe në profesionin tonë për të bërë reforma të mëdha.

Objektivë e ardhshme sipas Strategjisë 2020-2024 është transformimi digjital dhe ne duhet të përshpejtojmë iniciativat në këtë fushë.

Jam krenare që jam pjesë e këtij komunitetit të jashtëzakonshëm, të cilët kontribuojnë me punë e tyre profesionale në çdo sferë të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Dua të ju falënderoj për angazhimin, bashkëpunimin dhe përpjekjen tuaj të vazhdueshme për avancimin e profesionit tonë dhe avancimit të sistemit financiar në Kosovë.

Secili prej nesh ka një rol të rëndësishëm për të luajtur në punën përpara dhe jam e bindur se së bashku do të arrijmë suksese edhe më të mëdha.

Dua të falënderoj secilin nga stafi ynë, ligjëruesit, anëtarët e bordeve dhe komisioneve dhe më e rëndësishmja - anëtarët dhe studentët tanë. Ju na frymëzoni, na inkurajoni dhe na jepni qëllim.

Faleminderit për besimin tuaj tek ne ndërsa ne ecim si partnerë së bashku me ju drejt dekadës së tretë.



Zyra ekzekutive

Nga e majta poshtë: Burim Ahmeti, Lendita Shahini-Ustaibo, Naim Avdiu, Ardiana Bunjaku, Blerim Pushkolli

Nga e majta lartë: Arbër Hoti, Burbuçe Godanci, Edona Perjuci, Enkela Gjata, Liridona Sopa, Rina Sejdiu, Dafina Osmani, Avni Iseni.

AKTIVITETET E SHKÇAK GJATË VITIT 2021

Kur pandemia Covid-19 u përhap me shpejtësi në fillim të vitit 2020 pritej të zhdukej me shpejtësi në të njëjtin vit. Por në realitet ndodhi e kundërta. Covid 19 në forma të ndryshme është prezente dhe mjaft e rrezikshme edhe këto ditë dhe nuk mund të parashikohet fundi i tij.

Gjatë vitit 2021 bizneset dhe të gjithë sektorët e ekonomisë duhej të përgjigjeshin shpejt. Disa vazhduan të punojnë në distancë, ndërsa të tjerëve iu desh të vazhdonin të punonin me staf të plotë ose të reduktuar. Të tjerëve iu desh të mbyllnin plotësisht operacionet. Në cilëndo kategori që punohej, pandemia krijoi shumë rreziqe për sigurinë dhe shëndetin në punë. Rimëkëmbja - vazhdon të jetë prioritet i lartë për të gjithë.

Me kalimin e kohës, disa organizata ishin në gjendje të mirëpritnin stafin përsëri në vendet e punës, duke u siguruar që ata mund të ofronin një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm. Ndër to, edhe ne.

Për SHKÇAK siguria e stafit, studentëve dhe anëtarëve të saj është një prioritet mjaft sfidues. Nga pikëpamja e sigurisë të gjitha rreziqet ishin ende prezente, por ekipi i zyrës u inkurajua të punonte nga distanca aty ku ishte e mundur, ndërsa hapësira e zyrës u rimodelua për të lejuar distancimin social.

Kjo bëri të mundur që Shoqata gjatë vitit 2021 të mbetet e hapur dhe e aftë për të funksionuar në mënyrë të sigurt. Gjatë gjithë kësaj periudhe pasigurie, ne kemi qëndruar të përkushtuar në mbështetjen e profesionit. Ne i përfaqësuam anëtarët tanë përmes një zëri kolektiv, duke mbrojtur dhe ofruar mbështetje praktike dhe të menjëhershme për anëtarët tanë, duke iu përgjigjur zhvillimeve nga Covid 19, jo vetëm në mjedisin tonë operativ, por në mbarë shoqërinë.

Shumë nga proceset brenda Shoqatës kanë qenë të definuara megjithatë, kjo situatë na ka detyruar të bëhemi më dinamikë dhe fleksibël, me fokus në përmirësimin e vazhdueshëm drejt digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve.

Derisa pandemia ka paraqitur shumë sfida, ne jemi shumë mirënjohës për të gjithë studentët dhe anëtarët që kanë mbështetur punën tonë gjatë vitit duke u adaptuar të gjitha ndryshimet e shpejta e të imponuara në rrethanat e reja.

Puna jonë me ndikim dhe angazhim të lartë siguroi zhvillime pozitive për profesionin, duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

Profesioni dhe mjedisi ynë operativ po ndryshon, ne po ashtu. Ne udhëheqemi nga dhe për anëtarët.

DIGJITALIZIMI NE FOKUS TE SHKÇAK


Ne ekzistojmë për të qenë zëri i tyre drejt perfeksionit në profesion. Ne punojmë për të mbështetur një profesion të vlerësuar, duke ofruar shërbime më cilësore në interes të publikut, zhvillimit të ekonomisë dhe avansimit të shtetit ligjor.

Viti 2021 ishte viti i dytë i zbatimit të Strategjisë së Shoqatës 2020-2024.

Strategjia jonë mbetet e fokusuar dhe e pandryshuar në tri shtylla kryesore: përgatitjen e profesionistëve të së ardhmes, ofrimin e vlerës për anëtarët dhe të shërbyerit si qendër e ekselencës për zhvillim.

Shoqata ka vazhduar të implementojë programet e edukimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit, të mbajë anëtarët të përditësuar me zhvillimet e fundit të profesionit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe të sigurojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes menaxhimit të cilësisë.

Digjitalizimi i proceseve të SHKÇAK si një ndër prioritetet e Shoqatës, në këtë periudhë ka vazhduar me intesitet të shtuar. SHKÇAK gjatë vitit 2020 ishte pjesë e vlerësimit të gatishmërisë për digjitalizim të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit/Auditimit nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK). Raporti i vlerësimit nga FNK i pranuar gjatë vitit 2021 do të shërbejë si bazë për zhvillimin e planeve/aktiviteteve të ardhshme në procesin e digjitalizimit të aktiviteteve të SHKÇAK.



Transformimi digjital i referohet një transformimi të përgjithshëm të aktiviteteve organizative që synojnë shfrytëzimin e mundësive të krijuara nga teknologjitë dhe të dhënat digjitale, për të ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si veprojnë dhe u japin vlerë klientëve.

Në raport ndër të tjera thuhet që Transformimi digjital është i domosdoshëm për qëndrueshmërinë dhe përshtatjen e organizatave profesionale të kontabilitetit dhe kërkon që përdorimi i teknologjisë të jetë i drejtuar nga plani dhe parashikimi i të ardhmes së organizatës.

Ky proces për shumicën e organizatave është një plan afatgjatë, ndërsa mjedisi dhe trendet aktuale kanë përshpejtuar nevojën e përdorimit të teknologjisë me qëllim të përkrahjes dhe avancimit të proceseve biznesore për përmbushjen e kërkesave gjithnjë në ndryshim të biznesit dhe tregut në përgjithësi.

Transformimi digjital kërkon ndryshimin e kulturës organizative dhe mendësisë për organizatat, punonjësit dhe anëtarët, para se të konsiderohet përdorimi i teknologjisë apo mjeteve digjitale.

Transformimi digjital gjithashtu kërkon mbështetje të udhëheqjes organizative, në ndërtimin e aftësive të punonjësve, inkurajimin e tyre për të punuar në mënyra të reja dhe rritjen e komunikimit efektiv përgjatë gjithë procesit të transformimit.

Strategjia e zhvillimit të SHKÇAK 2020 – 2024

Revolucioni digjital pritet të sjell ndryshime të mëdha tek të gjitha kompanitë pavarësisht madhësisë. Përveç ndryshimit në modelet e biznesit, digjitalizimi do të prek edhe funksionet mbështetëse si kontabilitetin, kontrollet e brendshme dhe menaxhmentin.

Përpjekjet tona në këtë drejtim do të jenë të dyfishta. Në njërën anë ne synojmë të jemi në hap me ndryshimet teknologjike dhe të përcjellim ndryshimet që digjitalizimi do të sjell tek sistemet e kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara për të ofruar programe dhe trajnime që i pajisin anëtarët me aftësitë dhe shkathtësitë e nevojshme.

Në anën tjetër, ne synojmë që të përdorim teknologjinë digjitale për të krijuar platforma që na lejojnë të ofrojmë përmbajtje më të madhe, forcojmë komunitetin tonë profesional, dhe të mirëmbajmë programe relevante për anëtarët. Ne do të zhvillojmë e-platforma të cilat do të na mundësojnë të konvertojmë përmbajtjen ekzistuese në mësim dhe vlerësim online, dhe digjitalizojmë proceset tona të punës përfshirë formularët, aplikacionet etj.

Bazuar në këtë qëllim Bordi i ShKÇAK ka angazhuar Ekspertin në auditimin e teknologjisë informative dhe menaxhimin e sistemeve/projekteve i cili ka përgatitur raportin me rekomandimet për transformim digjital në ShKÇAK” brenda një periudhe 3-5 vjeçare.

Raporti bazohet në strategjinë e zhvillimit 2020-2024 të ShKÇAK si dhe rekomandimet nga raporti i vlerësimit të federatës ndërkombëtare të kontabilistëve (IFAC), dhe përfshinë:

- Analizën e gjendjes ekzistuese të Teknologjisë Informative dhe proceseve të punës
- Identifikimi i problemeve teknike
- Propozimi i zgjidhjeve të mundshme
- Rekomandimi i implementimit të zgjidhjeve në faza

Fokusi kryesor gjatë vitit 2022 do të jetë digjitalizimi i shërbimeve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj studentëve dhe anëtarëve. Transformi Digjital nënkupton sistem të centralizuar për menaxhimin e të gjitha shërbimeve për student dhe anëtarë duke përfshirë:

TEKNOLOGJIA INFORMATIVE NË SCAAK

Kualifikimet, Studentët Dhe Antarët

- Digjitalizimi i shërbimeve me qëllim të përmirësimit të shërbimeve ndaj studentëve dhe anëtarëve
- Aplikimi/pagesat online, proceset nga regjistrimi deri te certifikimi
- Kartela e studentëve dhe anëtarëve online

Raportet

- Gjenerimi i raporteve të rregullta
- Gjenerimi i raporteve sipas kërkesës apo kritereve të përcaktuara nga rregulloret
- Qasja në pasqyrë

Komunikimi

- Menaxhimi i kanaleve të komunikimit për ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe anëtarëve
- Digjitalizimi i sistemit të telefonisë
- Regjistrimi i kërkesave dhe komunikimit dhe mbajtja e histories
- Komunikimi mes Ligjeruesit - student

Të Dhënat

- Integrimi i të dhënave të studentëve/anëtarëve dhe ato financiare
- Mënaxhimi i të dhënave nëpërmjet sistemit, të eliminohen listat në Excel
- Përshtatshmëria me rregulloret e privatisë së të dhënave personale dhe siguria
- Menaxhimi i dokumenteve dhe orientimi i shfrytëzimit të shërbimeve në Cloud

Administrata

- Menaxhimi i proceseve të administratës,
- Menaxhimi i resurseve njerëzore
- Projektet
- Prokurimi

Menaxhimi i Mësimin Dhe i Kërkesave Online

- Menaxhimi i klasave, materialeve të mësimin
- Përgaditja e detyrave, ushtrimeve, etj
- Online Video prezentimi
- Kuize, Testimet online

Mbledhja e Kuvendit të Anëtarëve

Fillimi i vitit 2021 është karakterizuar me shumë aktivitete dhe angazhim intensiv të Zyrës Ekzekutive dhe Bordit të Shoqatës në përgatitjet dhe organizimin e Mbledhjes së Kuvendit.



Mbledhja e Kuvendit u mbajt me 16.03.2021 në mënyrë virtuale duke respektuar rekomandimet nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHPK) për parandalimin dhe luftimin e Covid 19.

Në mbledhjen e Kuvendit, anëtarët aprovuan: raportin e aktiviteteve dhe raportin e pasqyrave financiare të audituara për vitin 2020; planin e punës dhe buxhetin për vitin 2021; pagesën e tarifës për MCPS gjatë vitit 2021; kompaninë “ACA” për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2021-2023; znj. Shpresa Mustafa, Kryetare Bordit si Përfaqësuese e Autorizuar e SHKÇAK, si dhe Statutin e ri të SHKÇAK.



Statuti i prezantuar para anëtarëve i ka përfshirë disa ndryshime tejet të rëndësishme që kanë për qëllim forcimin e rolit të anëtarëve dhe Shoqatës në tërësi. Ndryshimet kryesore janë reflektimet në të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve gjithashtu në kuadër të përbërjes së anëtarëve, Statuti përfshin edhe Auditorin e Brendshëm të Çertifikuar si anëtar me të drejtë vote dhe obligime të plota. Statuti, poashtu me nen të veçantë i përcakton subjektet e asocuara, të drejtat dhe obligimet e tyre.

Me rëndësi të përmendet në kuadër të këtyre ndryshimeve është obligimi i përmbushjes së detyrimeve të anëtarëve Me Statutin e Shoqatës është përcaktuar edhe obligimi i anëtarëve për pjesëmarrje në takimet e Kuvendit dhe deklarimin e votës për, kundër dhe abstenim.



QEVERISJA E MIRË

ShKÇAK implementon objektivat strategjike përmes Bordit dhe Komisioneve të saj.

ShKÇAK gjatë vitit 2021 fokus të vecantë i ka dhënë “Ruajtjes së qeverisjes së mirë” dhe ka punuar intenzivisht me anëtarët e Bordit, Komisionet e saj dhe Zyrën Ekzekutive. Duke e marrë për bazë dinamikën e zhvillimit të profesionit dhe Shoqatës në vitet e fundit, në vazhdimësi paraqitet nevoja e rishikimit dhe plotësimit të akteve normative të Shoqatës dhe sidomos ky rishikim dhe plotësim është edhe si rezultat i ndryshimeve në Statutin e Shoqatës.

Në vazhden e këtyre ndryshimeve ka rezultuar nevoja e ndryshimit dhe harmonizimit të akteve normative të Shoqatës me Statutin e aprovuar nga anëtarët e Shoqatës. Në këtë drejtim, Bordi i Shoqatës pas rishikimit të ndryshimeve të reflektuara, në vitin 2021 ka aprovuar këto rregullore.

- Rregullore mbi obligimet e anëtarëve dhe subjekteve të asocuara;
- Rregullore e punës së Kuvendi të anëtarëve;
- Rregullore e punës së Bordit të Shoqatës;
- Rregullore financiare;
- Rregullore administrative;
- Rregullore e Komisionit për Nominime;
- Kodi i mirësjelljes në punë.



Të gjitha rregulloret e aprovuara përmbajnë dispozita shumë të rëndësishme dhe të qarta për sa u përket të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve por edhe të subjekteve të asocuara.

Njëra prej këtyre rregulloreve që duhet të ketë vëmendjen e anëtarëve është rregullorja mbi obligimet e anëtarëve dhe subjekteve të Asocuar. Kjo rregullore më gjerësisht e rregullon aspektin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve si dhe pasojat që vijnë në rast të mos përmbushjes së obligimeve si atyre financiare poashtu edhe të obligimit për pjesëmarrje në Kuvendin e Anëtarëve dhe deklarim të votës për çështjet për të cilat është paraparë votimi.

Për përmbushjen e obligimeve kjo rregullore, gjithnjë konform Statutit, i ka përcaktuar afatet konkrete.

Në kuadër të obligimeve të anëtarëve, kjo rregullore përcakton obligimin e anëtarëve si subjekte të Menaxhimit të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde dhe obligimin e pagesës së tarifës së përcaktuar. Inkorporimi i këtij obligimi krahas obligimeve tjera ka për qëllim që përmes këtij procesi tu ndihmohet anëtarëve tanë për një performancë sa më efikase duke i aplikuar standardet më të larta profesionale.

Shoqata sot ka një numër të madh të anëtarëve dhe studentëve të cilat janë në proces të certifikimit dhe arritjes së thirrjeve profesionale. Duke e marrë këtë në konsiderim, Statuti por edhe kjo Rregullore i ka përfshirë si kategori edhe Subjektet e Asocuar, të drejtat dhe obligimet e tyre.

Risi e kësaj rregullore është mundësia e pasivizimit të thirrjeve profesionale si mundësi për anëtarët të cilët nuk e ushtrojnë profesionin. Pasivizimi i thirrjes profesionale sipas këtyre dispozitave bëhet për së paku një vit dhe rregullorja i përcakton hapat që duhet respektuar dhe aplikuar për pasivizim.

Në kuadër të akteve normative të aprovuara me një peshë të madhe është edhe Rregullorja e Komisionit për Nominime e cila e bën një ndarje të procesit të nominimit për Bordin e Shoqatës, komisioneve që zgjedhën nga Kuvendi dhe Komisioneve që zgjedhën nga Bordi i Shoqatës.


Kjo rregullore e përshkruan tërë procesin duke filluar nga shpallja e ftesës për nominime deri te zgjedhja e anëtarëve.

Dispozitat e qarta të këtij dokumenti kanë për qëllim inkurajimin e anëtarëve për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të nominuar dhe për tu nominuar dhe përfundimisht për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur.

Rregullorja mbi punën e Kuvendit të Anëtarëve dhe Rregullorja mbi punën e Bordit të Shoqatës në mënyrë decitive e përcaktojnë punën, të drejtat dhe përgjegjësitë dhe kompetencat e këtyre organeve më të larta të Shoqatës. Rregullorja mbi punën e Kuvendit të anëtarëve, duke u bazuar në Statut, e përcakton datën e fundit për mbajtjen e s së Kuvendit e konform kësaj edhe datën e dërgimit të materialeve për Kuvendin e anëtarëve. Kjo rregullore gjithashtu e përcakton afatin e fundit për përmbushjen e obligimeve nga anëtarët si dhe pasojat që dalin nga mos përmbushja e tyre.

Përfundimisht, konsiderojmë se aprovimi i këtyre akteve normative dhe funksionalizimi i tyre është në interes të anëtarëve tanë dhe përgjithësisht në interes të Shoqatës. Ajo që ne si Shoqatë dhe si anëtarë duhet ta kemi si objektiv është respektimi i këtyre akteve me qëllim të mbrojtës së anëtarëve dhe profesionit dhe interesit publik.

SHKÇAK gjithashtu ka organizuar edhe punëtorinë me anëtarët e Bordit, Komisionet e saj dhe Zyrën Ekzekutive me qëllim të përcaktimit dhe planifikimit të aktiviteteve të punës për vitin 2022, për të implementuar objektivat strategjike të ShKÇAK, përmes digjitalizimit të proceseve dhe sistemeve. Punëtorja konfirmoi vizionin e SHKÇAK, e cila siguron një ndërlidhje të duhur të roleve me fokus për mbrojtjen e interesit publik dhe zhvillimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.



Mirëmbajtja dhe përditësimi i njohurive përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional

ShKÇAK në vazhdimësi kujdeset që anëtarët e saj të kenë informacionet e fundit mbi profesionin dhe është e domosdoshme që ata të jenë të përgatitur për ndryshimet e vazhdueshme në tregun e punës siç janë azhurnimi i standardeve dhe teknologjitë e reja në mënyrë që të ofrojnë shërbime cilësore për klientët apo për punëdhënësit e tyre.

Gjatë vitit 2021, ShKÇAK gjithashtu ka vazhduar marrëveshjen me Zyrën Kombëtare të Auditimit përmes së cilës profesionistët e punësuar në këtë institucion do të mund të ndjekin sesionet e EVP-ve të Shoqatës. Përmes përditësimit të njohurive të profesionistëve të këtij institucioni, ShKÇAK kontribuon në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të parasë publike në të gjitha institucionet shtetërore.

Edhe gjatë vitit 2021 Shoqata ka vazhduar të ofrojë sesione të EVP me tema relevante për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, të cilat janë bazuar në kërkesat e vetë profesionistëve, në zhvillimet dhe ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në vend dhe në botë si dhe në çështje të rëndësishme që ka identifikuar Departamenti i Menaxhimit të Cilësisë i Shoqatës gjatë punës së tyre.

EVP-të e realizuara gjatë vitit 2021:

- SNA 220 Menaxhimi i Cilësisë për një Auditim të Pasqyrave Financiare (i rishikuar) dhe Standardet tjera të ndërlidhura ;
- SNA 315 - Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale dhe SNA 330 - Përgjigja e Auditorit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara dhe SNA 805 - Konsiderata të veçanta - Auditimet e Pasqyrave Financiare të vetme dhe elementet specifike, llogari ose zëra të një Pasqyre Financiare;
- SNK 36 - Dëmtimi i Pasurive dhe SNRF 16 – Lizingu;
- SNA 330 - Përgjigja e Auditorit ndaj Rreziqeve të Vlerësuara dhe SNA 805 - Konsiderata të veçanta - Auditimet e Pasqyrave Financiare të vetme dhe elementet specifike, llogari ose zëra të një Pasqyre Financiare;
- Metodot e matjes së performancës të bazuara në treguesit jo financiar (kartela e rezultateve të balancuara, blloqet e ndërtimit)”
Zbatimi i kërkesave të standardeve ndërkombëtare për Auditim të Brendshëm – raste praktike;
- Analiza e Pasqyrave Financiare;
- Digjitalizimi i profesionit-përparësitë dhe sfidat e implementimit të zhvillimeve të reja teknologjike ;
- SNA 800 - Konsiderata të veçanta - auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura në pajtueshmëri me korniza për qëllime të veçanta dhe ISRS 4400 - Angazhimet për procedurat e rena dakord (i rishikuar);

- Zbatimi në Praktikë i Procedurave Analitike të Auditimit-rast studimi – Sesioni 2;
- Digjitalizimi i profesionit-përparësitë dhe sfidat e implementimit të zhvillimeve të reja teknologjike;

Menaxhimi i cilësisë për pajtueshmëri me standarde (MCPS)

MCPS është fokusuar në shtimin e vlerës për anëtarë dhe në digjitalizimin e procesit të raportimit vjetor të anëtarëve të Shoqatës. Këtë vit për herë të parë, anëtarët e shoqatës, Auditor Ligjor, Auditor/Kontabilist të certifikuar dhe Auditor të Brendshëm të certifikuar, kanë raportuar aktivitetet vjetore përmes platformës elektronike të raportimit të zhvilluar nga shoqata.

Pas një raportimi të suksesshëm të aktiviteteve vjetore nga anëtarët, Departamenti për MCPS, ka përmbledhur të informatat nga raportimi; ka përzgjedhur anëtarët për menaxhim të cilësisë në bazë të thirrjes profesionale si dhe ka përgatitur Raportin vjetor për mbarëvajtjen e procesit të raportimit të anëtarëve, të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për MCPS.

Janë rishikuar për pajtueshmëri me standardet anëtarët të cilët mbajnë thirrjen profesionale Auditorëve/Kontabilistëve të certifikuar dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet janë komunikuar dhe shqyrtuar me anëtarë. Pas diskutimit të gjetjeve dhe rekomandimeve janë përgatitur Raportet e vlerësimit, të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për MCPS.

Departamenti për MCPS ka kontribuar në përgatitjen e dokumentit me propozime dhe rekomandime për reformimin e sistemit financiar dhe auditimit në Kosovë, si dhe ka përgatitur pasqyrat e krahasimit të kërkesave të Direktivave dhe Rregulloreve relevante të BE-së me kërkesat e Ligjit aktual në fuqi për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim. Rekomandimet për reformim të sistemit financiar janë dërguar Qeverisë.


Po ashtu, gjatë këtij viti në kuadër të publikimit të Hulumtimit për Cilësisë e Pasqyrave Financiare të Audituar të Ndërmarrjeve në Kosovë për vitet raportuese 2017, 2018 dhe 2019. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë që niveli i cilësisë së raportit të auditorit dhe pasqyrave financiare të audituara të ndërmarrjeve në Kosovë, përkundër përmirësimeve të identifikuar gjatë viteve të fundit, ka ende hapësirë për përmirësim.

Departamenti për MCPS në bashkëpunim me Komisionin për Sjellje dhe Disiplinë ka përgatitur një anketë rreth zbatimit të Kodit të Etikës të BSNEK/ IESBA dhe problemet dhe sfidat etike me të cilat ballafaqohen anëtarët e ShKÇAK. Gjithashtu është përgatitur një broshurë e etikës profesionale e cila ju është dërguar anëtarëve. Ndërsa pas mbylljes së anketimit Departamenti për MCPS ka përgatitur raport përmbledhës nga pjesëmarrja e anëtarëve në anketim dhe përgjigjet e tyre.



**BROSHURË -
ETIKA PROFESIONALE**

Programet çertifikuese të ShKÇAK - Organizimi i trajnimeve në mënyrë virtuale



Viti 2021 ka shënuar rritje të numrit të kandidatëve të interesuar për të ndjekur edukimin profesional në kontabilitet dhe auditim, dhe Shoqata ka vazhduar të përkujdeset që atyre të i'u ofrohen programe çertifikuese dhe specializuese të bazuara në standardet ndërkombëtare të edukimit.

Shoqata edhe këtë vit ka vazhduar me aktivitetet e programeve çertifikuese të sektorit privat dhe auditimit të brendshëm si dhe me ofrimin e programeve specializuese në fushën e forenzikës financiare dhe tatimeve.

Situata e rënduar pandemike ka bërë që edhe gjatë vitit 2021, trajnimet të organizohen në mënyrë virtuale, me platforma të përshtatshme si për kandidatët ashtu edhe për ligjëruesit.

Ekipi Ekzekutiv ka bërë vlerësim të platformave të ndryshme elektronike që mund të përdoren për mbajtjen e ligjëratave në mënyrë virtuale, dhe vendosi të vazhdojë me Zoom si platformën më të përshtatshme për shkak të veçorive të tij që plotësojnë kërkesat për ofrimin e ligjëratave në mënyrë virtuale, dhe për shkak të përvojës pozitive që stafi kishte më parë me platformën.

Sistemi online i mbajtjes së ligjëratave ka rezultuar deri më tani të jetë i suksesshëm edhe nga vlerësimet e kandidatëve edhe nga rezultatet e provimeve, gjithashtu edhe ligjëruesit tanimë janë akomoduar me këtë sistem të ligjërimit.

ShKÇAK në vazhdimësi ka asistuar ligjëruesit dhe studentët gjatë procesit të mbajtjes së trajnimeve online. Ndër të tjera, ShKÇAK ka përgatitur edhe Udhëzuesin për përdorimin e platformës Zoom i cili i është dërguar të gjithë studentëve.

Në mënyrë që ShKÇAK të mbajë nivelin e lartë të trajnimeve dhe ligjëruesve të saj, në çdo sesion të trajnimeve ShKÇAK përgatit dhe dërgon tek anëtarët/studentët pyetësorët për vlerësimin e ligjëruesve.

Ndërkaq, provimet janë mbajtur fizikisht gjatë vitit 2021 gjithmonë sipas rekomandimeve dhe udhëzimeve të IKSHPK-së dhe bazuar në procedurën e përkohshme për organizimin dhe mbajtjen e provimeve gjatë pandemisë të ShKÇAK.

Gjithashtu është vazhduar me procesin e digjitalizimit të programeve të ShKÇAK, janë bërë përgatitjet për lansimin e trajnimeve online për Ekspertë Tatimor, në bashkëpunim me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).

Duke u bazuar në marrëveshjen me BPP Learning Media, ofrueshin botëror të materialeve të studimit për kontabilitet dhe auditim, Shoqata gjatë vitit ka punuar intenzivisht në azhurnimin e materialeve në gjuhën shqipe në mënyrë që kandidatët të fitojnë njohuritë më aktuale duke përfshirë këtu standardet ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të rishikuara.

Në bashkëpunim me Komisionin e Edukimit janë rishqyrtuar ndryshimet e nevojshme në planprogramin e ShKÇAK, për të reflektuar kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit dhe azhurimet në Standardet tjera të profesionit.

Gjatë vitit 2021, përpos që janë azhuruar materialet eksiztuuese, janë përfshirë më shumë kapituj në lëndë të ndryshme mbi teknologjinë informative, gjithashtu është marr vendim që të përfshihen lëndë të reja në planprogram, të cilat do të fillojnë implementimin prej vitit 2023.

Programet çertifikuese të ShKÇAK vazhdojnë të jenë të akredituar nga Organizatat Profesionale Globale anëtare të FNK.

Gjithashtu programet çertifikuese të ShKÇAK vazhdojnë të jenë të akredituara Agjensionin Kombëtar të Kualifikimeve dhe gjatë vitit 2021 janë dorëzuar dokumentacionet në AKK sipas kërkesave të tyre.

Në kuadër të edukimit profesional, Zyra Ekzekutive e ShKÇAK ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e FNK dhe ka shkëmbyer informatat e zhvillimeve në profesionale si dhe është njoftuar me planet që FNK është duke i hartuar për vitet në vijim ku si fokus kryesor vazhdon të jetë digjitalizimi i të gjitha proceseve.

AKTIVITETET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Takim me Auditoren e Përgjithshme të Republikës së Kosovës

Drejtoresha Ekzekutive Ardiana Bunjaku ka takuar Auditoren e Përgjithshme, Znj. Vlora Spanca, pas marrjes së detyrës në udhëheqjen e Zyrë Kombëtare të Auditimit, dhe ka shprehur gatishmërinë për avancimin e bashkëpunimit përmes programeve certifikuese si dhe shkëmbimit të përvojave e praktikave më të mira në fushën e trajnimeve dhe zhvillimeve profesionale me fokus të theksuar në ngritjen e kapaciteteve.



Me këtë rast Auditorja e Përgjithshme, Znj. Spanca, e ka vlerësuar të rëndësishëm bashkëpunimin e deritanishëm në mes të ZKA-së dhe shoqatave profesionale, në këtë rast me ShKÇAK-n, duke thënë se ky nivel i bashkëpunimit do të avansohet edhe më tutje.

Znj. Spanca ka bërë me dije se një ndër prioritetet kryesore të ZKA-së mbetet trajnimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore, proces ky që i kontribuon rritjes së cilësisë së punës.



Takim me Këshillin për Raportim Financiar, Kontabilitet dhe Auditim

Gjatë këtij viti Këshilli Kosovar për Raportim Financiar ka ftuar në takim tre Shoqatat Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit në Kosovë për të diskutuar mbi angazhimin e OPK-ve në përfitimin e statusit të bashkëpunuesit me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK) pasi që sipas Ligjit nr.06/L - 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, OPK-të duhet të përfitojnë statusin e anëtarit të asociuar deri në fund të vitit 2021.



ShKÇAK me zgjedhjen e anëtarëve të rinj në dhjetor 2021 të KKRF ka përgatitur rekomandimet mbi reformimin e sistemit të raportimit financiar dhe auditimit në Republikën e Kosovës. Këto rekomandime kanë për synim avancimin në çështjet kyçe për të përafuar legjislacionin Kosovar të kontabilitetit, raportimit financiar dhe auditimit me Direktivat e Bashkimit Evropian dhe *acquis communautaire*. Rekomandimet kryesore janë paraqitur si në vijim:

- KKRF duhet të zhvilloj një platformë softuerike e cila mundëson dorëzimin, përpunimin elektronik dhe publikimin e regjistrimit vjetor të pasqyrave financiare si dhe që KKRF të qartësoj me ATK-në, që pasqyrat financiare që dorëzohen nëpërmjet sistemit 'EDI' mund të përdoren vetëm për qëllime të KKRF-së, e jo të jenë dokumente burimore bazë për inspektorët e ATK-së.
- Të zbatohen praktikat më të mira dhe direktivat e BE-së që përcaktojnë se Bordi i Mbikëqyrjes Publike (BMP) duhet të jetë organi i pavarur dhe i veçantë, përgjegjës për kontrollin e cilësisë së auditorëve ligjor dhe firmave ligjore të auditimit. Në aspektin statutor, KKRF dhe BMP kanë nevojë të kenë statusin e dy agjencioneve të pavarura, në mënyrë që të vetë financohen nga të hyrat që do t'i realizojnë nga shërbimet që i ofrojnë sipas funksionit. Në këtë mënyrë, KKRF dhe BMP mund të kenë mundësinë të ngritin kapacitetet profesionale dhe teknike për kryerjen e funksioneve të tyre. Këtu përfshihen, punësimi i stafit profesional me eksperiencë direkte në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, e veçanërisht në fushën e kontrollit të cilësisë, të cilët mund t'i kompensoj me pagë sipas vlerës së tregut.

- Për shkak të mungesës së fondeve dhe ekspertëve me përvojë në fushën e auditimit dhe kontrollit të cilësisë KKRF, respektivisht BMP deri me sot nuk ka kryer asnjë kontroll të cilësisë së auditimeve ligjore. Meqenëse direktivat e BE-së lejojnë delegimin e përgjegjësiave tek organet tjera propozohet që KKRF të ndjek shembullin e vendeve fqinje dhe të delegoj përgjegjësinë e sigurimit të cilësisë të auditimit të ndërmarrjeve tjera që nuk janë ndërmarrje me interes publik, tek OPK-të që janë anëtare të FNK-së.
- Të ndahet buxhet i veçantë për KKRF-në për përkthim dhe publikim në gjuhët zyrtare të të gjitha standardeve për të cilat është përgjegjës sipas nenit 22 të ligjit aktual në fuqi.
- Auditorët ligjor dhe firmat ligjore të auditimit janë të obliguar që për çdo vit të aplikojnë për vazhdim të licencës duke kompletuar të njëjtat dokumente sikur edhe për vitet më parë dhe të paguajnë tarifave të larta për vazhdim të licencës. Kjo praktikë krijon ngarkesë të dukshme për auditorët dhe firmat e auditimit si në aspektin kohor ashtu edhe në atë financiar.
- Vazhdimi i licencës si kërkesë vjetore në vendet e zhvilluara por edhe ato të rajonit tashmë nuk përmendet si kategori, ku licenca lëshohet në afat të pacaktuar dhe mirëmbajtja e saj është subjekt i plotësimit të kërkesave të përcaktuara.
- Rekomandojmë që të implementohen edhe në Kosovë praktikat e mira të vendeve të zhvilluara ku licencimi nuk ka kohëzgjatje. Çështja e validitetit të licencës së auditorit do të duhet të ndërlihet me praktikimin e profesionit me integritet, etikë dhe sipas standardeve përkatëse. Mbajtja e licencës realizohet përmes përmbushjes së kërkesave të reputacionit të mirë, edukimit të vazhdueshëm profesional si dhe rezultateve të punës nga Kontrolli i cilësisë e cila realizohet së paku një herë në tre (3) vite nga Autoriteti kompetent i paraparë sipas Ligjit në fuqi me ç’ rast edhe nënkupohet vazhdimësia e licencës së auditorit dhe/ose firmës së auditimit.
- Regjistri publik i auditorëve ligjor dhe firmave ligjore të mos ketë fare ndarje të tillë si ‘vendor’ dhe ‘të huaj/jashtëm’, por të listohen të gjithë në një vend, pa dallim.
- KKRF të ndjek shembullin e vendeve fqinje dhe atyre të BE-së dhe të delegoj përgjegjësinë e sigurimit të cilësisë të auditimit të ndërmarrjeve tjera që nuk janë ndërmarrje me interes publik (JO-SIP) tek OPK-të që janë anëtare të FNK-së. Në këtë mënyre OPK-të do të mund të zbatojnë kërkesat ligjore për raportim për sigurimin e cilësisë së anëtarësive të tyre.
- KKRF të veprojë konform detyrimit të saj ligjor për revokim licence në raport me OPK-të të cilat nuk janë anëtarësuar në FNK, deri në plotësim të kushtit të anëtarësimit.
- Aktualisht në Kosovë janë tre (3) OPK të licencuara nga KKRF: ShKÇAK, IKAF dhe IAAB. Sipas kërkesës ligjore, nenit 3, paragraf 1, pika 13 të Ligjit për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim një OPK i kërkohet që brenda periudhës tre (3) vjeçare të bëhet anëtare e asociuar në FNK dhe brenda 5 viteve anëtarë me të drejta të plota e FNK-së, nga hyrja në fuqi e Ligjit.

Meqenëse vetëm SHKÇAK e gëzon anëtarësinë në këtë Federatë, me përfundim të vitit 2021 (31.12.2021), KKRF-ja në zbatim të ligjshmërisë, duhet të veprojë konform nenit 33.3. dhe shoqatave të cilat nuk janë të anëtarësuara në FNK t'ua revokojë licencat deri në përmbushje të kushtit ligjor për anëtarësim (fillimisht si anëtar i asociuar), meqë kjo dispozitë ligjore është e karakterit imperativ.

Citim i nenit 33, paragrafi 3:

'Në rast të mos përmbushjes së kërkesës për anëtarësim në FNK sipas dispozitave të këtij Ligji, shoqatës i revokohet licenca nga KKRF.'

Përkujtojmë se SHKÇAK ka treguar gatishmëri për t'i sponsoruar IKAF dhe IAAB në procesin e anëtarësimit në FNK brenda afatit ligjor të kërkuar me Ligj , por nuk ka hasur në bashkëpunim nga ana IKAF për të respektuar kërkesat për dorëzim dokumentacioni sipas standardeve që kërkohen nga FNK-ja. IAAB ka shprehur interesim gjate vitit 2021 dhe filluar komunikimin me SHKÇAK por afati kohor nga shprehja e intresimit ka qenë i tejet i shkurtër për përfundimin e procesit.

- Bashkëpunim mes KKRF-së dhe AKK-së lidhur me akreditimin/licencimin e OPK-ve, duke mos e minimizuar rëndësinë e asnjërit institucion.
- Duke marrë për bazë që Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim kërkon që OPK-të të jenë anëtare të FNK propozohet që OPK-të me anëtarësi në FNK të largohen nga obligimi i raportimit çdo pesë (5) vite pasi që ato monitorohen drejtpërdrejtë nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK).
- Janë paraqitur edhe disa nga dispozitat ligjor të Direktivave të Bashkimit Evropian të cilat nuk kanë referencë në Ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim në Kosovë dhe të cilat po të implementoheshin do të përaftronin edhe më shumë ligjin me kërkesat e Direktivave të Bashkimit Evropian dhe *acquis communautaire*.

Takime me Odat Ekonomike

ShKÇAK duke qenë anëtare në Odat Ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë përfaqësonë anëtarët e saj përmes pjesëmarrjes në cilësi të anëtarit të bordit apo anëtarë të komisioneve të ndryshme gjatë këtij viti ka qenë mjaft aktive në lidhje me zhvillimet dhe të rejtat e fundit, duke kontribuar me rekomandime për ndryshime në legjislacion, në avokimin e rëndësisë së raportimit financiar, profesionit të kontabilitetit dhe auditimit dhe çështje tjera me interes publik.



Ndikimi i COVID-19 mbi kompanitë e sektorit privat, si dhe implikimet në obligimet e tyre tatimore, por edhe marrëdhëniet e përgjithshme me Administratën Tatimore të Kosovës, ishin në fokus të tryezës së diskutimit me Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore.



Takimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT)

ShKÇAK është përzgjedhur si PILOT projekt nga MINT në kuadër të projektit të Binjakëzimit të BE-së “Asistencë për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit” që do të po implementohet lidhur me themelimin dhe lansimin e Pikës së Vetme të Kontaktit, qëllimi i së cilës ndër të tjera është edhe digjitalizimi i ofrimit të shërbimeve.

Ky aktivitet do të realizohet në bashkëpunim me ekspertët e projektit dhe ekspertët e Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Pas përfundimit të digjitalizimit të shërbimit, sektori do të vendoset në portalin e-Kosova ku pritet që edhe licencimi Auditorëve, Kontabilistëve do të mund të bëhet në mënyrë elektronike.

Pjesëmarrja në panairin virtual të Punës dhe Karrierës

ShKÇAK mori pjesë në Panairin Virtual të Punës dhe Karrierës për t'i informuar më shumë të interesuarit rreth mundësive të punësimit në ShKÇAK.



Pjesëmarrja në sesionin informues “Avancimi Profesional në Fushën e Financave” të organizuar nga DIMAK

Drejtoresha Ekzekutive e SHKÇAK znj. Ardiana Bunjaku ishte e ftuar në sesionin informues me temën: “Avancimi Profesional në Fushën e Financave”. Në këtë sesion u diskutua rreth Shërbimeve të SHKÇAK dhe programeve të certifikimit dhe specializimit si dhe Kompetencave të nevojshme për fushën e raportimit financiar, kontabilitetit, auditimit dhe etikës profesionale.



BASHKËPUNIMI RAJONAL

Përfaqësues të ShKÇAK zhvilluan një takim virtual me përfaqësues të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM) të Shqipërisë.



Takim virtual në mes të ShKÇAK dhe Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe Institutit të Kontabilistëve të Miratuar (IKM) të Shqipërisë.

Diskutimet gjatë takimit u fokusuan në mundësitë e organizimit të sesioneve të përbashkëta të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, përkthimin e Standardeve të reja për Menaxhimin e Cilësisë, bashkëpunimin në sferën e sigurimit të cilësisë si dhe bashkëpunimin në ofrimin e çertifikimit të përbashkët për sektorin publik.

Të tre Shoqatat e lartpërmendura, si anëtare me të drejta të plota në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK) u dakorduan që të jenë zë i përbashkët i zhvillimit të profesionit në rajon dhe më gjerë.

Pjesëmarrja në simpoziuin e Institutit të Kontabilistëve të Çertifikuar të Malit të Zi

Përfaqësues të ShKÇAK gjatë këtij viti morën pjesë në simpoziuin dy-ditor të organizuar nga Instituti i Kontabilistëve të Çertifikuar të Malit të Zi, ku në panelin 'Transformimi digjital apo vetë-izolimi' është prezantuar tema 'ShKÇAK - Rezultatet e vlerësimit të gatishmërisë digjitale'.

Përfaqësuesit e ShKÇAK kanë marrë pjesë në simpoziuin dyditor të organizuar nga Instituti i kontabilistëve të certifikuar të Malit të Zi, ku në panelin 'Transformimi dixhital apo vetë-izolimi' është prezantuar tema 'SCAAK - Rezultatet e vlerësimit të gatishmërisë dixhitale'.

Në këtë prezantim janë paraqitë rezultatet e gatishmërisë dixhitale të ShKÇAK sipas fushave/kategorive dhe nënkategorive tematike bazuar në pyetësorin/platformën e përgatitur nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) dhe cloudThing për vlerësimin e gatishmërisë dhe burimeve dixhitale të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit.

SCAAK - Rezultati digitalne procjene spremnosti




- IFAC i cloudThing stvorili su alatku (upitnik) za procjenu digitalne spremnosti i resursa Profesionalnih Računovodstvenih Organizacija
- U nastavku biće prikazani rezultati digitalne spremnosti SCAAK-a po tematskim oblastima/kategorijama i pod-kategorijama.

SHKÇAK AKTIVE NË SFERËN GLOBALE

Përfaqësuesit e ShKÇAK kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me përfaqësuesit e FNK, EFAA dhe FCM dhe kanë shkëmbyer informatat e zhvillimeve të fundit në profesion si dhe me planet që Federatat janë duke i hartuar për vitet në vijim ku si fokus kryesor vazhdon të jetë digjitalizimi i të gjitha proceseve. ShKÇAK gjithashtu ka qenë aktive në diskutimin dhe komentimin e drafteve të ndryshme të lëshuara nga standardvënësit global.

Duke qenë anëtare me të drejta të plota ShKÇAK ka marrë pjesë në takimet vjetore të Federatave ku janë marrë vendime strategjike, aprovim të raporteve vjetore dhe atyre financiare, buxhetit, planit të punës etj.

Gjatë kësaj periudhe FNK, EFAA dhe FCM kanë organizuar uebinare të shumta ku përfaqësuesit e ShKÇAK kanë marrë pjesë. Gjithashtu Drejtoresha ekzekutive ka marrë pjesë në Forumin e Drejtorëve ekzekutiv me temën “Transformimi dhe evolimi i OPK-ve: rrugëtimi ynë i përbashkët”.



Gjatë pjesëmarrja në Konferencën Ndërkombëtare të Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM (EFAA) në sesionin me temën “Transformimi Digjital” e ftuar si paneliste ishte Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK – Znj. Ardiana Bunjaku, ku për pjesëmarrësit ndau eksperiencën mbi digjitalizimin e ShKÇAK si Organizatë Profesionale e Kontabilitetit dhe Auditimit. Në këtë konferencë gjithashtu morën pjesë dhe Presidenti i EFAA – Z. Salvador Marin si dhe Presidenti i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Auditimit (IFAC) – Z. Alan Johnson, anëtarët e EFAA dhe akterë të tjerë relevant.

ShKÇAK vazhdon të jetë pjesë në Programet e Qendrës për Reforma në Raportim Financiar të Bankës Botërore.



Si pjesë e Qendrës për Reforma në Raportimin Financiar (QRRF) të Bankës Botërore, përfaqësuesit e ShKÇAK-së në vazhdimësi kanë qenë pjesë e seminareve dhe punëtorive të organizuara nga kjo qendër.

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në serinë e uebinarëve 'Zbatimi i Rregullores së Auditimit Ligjor në Bashkimin Evropian: Përvoja e Sllovenisë' të organizuar nga Qendra për Reformimin e Raportimit Financiar (QRRF), Banka Botërore, në bashkëpunim me Agjencinë për Mbikëqyrjen Publike të Auditimit të Sllovenisë gjatë të cilit u prezantuan mbikëqyrja publike dhe sistemet e sigurimit të cilësisë së auditimit, parimet kryesore të mbikëqyrjes së auditimit dhe proceseve të sistemeve të sigurimit të cilësisë.
- Edukimi në Kontabilitet për Sektorin Publik, në të cilin janë diskutuar azhurnimet nga udhëzuesit e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK) dhe është prezantuar pyetëtori hulumtues dhe rezultatet e tij nga Komuniteti për Edukim Profesional (PULSAR EduCop), zhvillimet kyçe si dhe plani i vitit 2021.
- "Ngritja e nivelit të menaxhimit të cilësisë: Standardet e reja të menaxhimit të cilësisë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB/BSNAS)" e organizuar nga FNK dhe Banka Botërore. Standardet e reja Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë (ISQM) promovojnë një qasje të fuqishme, proaktive, të shkallëzuar dhe efektive për menaxhimin e cilësisë dhe shënojnë një evolucion të rëndësishëm të standardeve ekzistuese


të kontrollit të cilësisë. Znj. Sue Almond, Anëtare e Bordit të IAASB/BSNAS dhe anëtare e Task Forcës ISQM 1 dhe Znj. Natalie Klonaridis, Zëvendës Drejtore e IAASB/BSNAS prezantuan mbi aspektet kryesore të ISQM dhe u përgjigjën pyetjeve të pjesëmarrësve. Në këtë uebinar ishin pjesëmarrës afro 871 të pranishëm që përfaqësonin 68 vende.



- Punëtori e organizuar në kuadër të programit PULSAR me temë “ Zbatimi për herë të parë i IPSAS: Mësimet e nxjerra “. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte që tu ofrohet ndihmë qeverive të cilave u është besuar të administrojnë burimet publike dhe të ofrojnë një gamë të gjerë të shërbimeve publike në një mënyrë të shëndoshë, me kosto efektive dhe të qëndrueshme. Sidoqoftë, shumë vende ende përballen me sfida të rëndësishme në cilësinë e raportimit financiar, përfshirë qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë e tij, andaj pjesëmarrësit nga vendet në zhvillim përfituan mjaft shumë nga kjo punëtori duke ndarë përvojat e përbashkëta. Gjithashtu objektivat kryesore të kësaj punëtorie ishin: (i) paraqitja e gjetjeve kryesore të publikimit më të fundit nga PULSAR FinCoP “Adoptimi për herë të parë i bazës së përlogaritur IPSAS”; (ii) diskutojnë sfidat e përbashkëta dhe mësimet e marra lidhur me zbatimin për herë të parë të IPSAS; (iii) ndajnë përvojat përkatëse të vendeve në rrugëtimin drejt zbatimit të IPSAS.
- Edukimin në Kontabilitet për Sektorin Publik, në të cilin janë diskutuar azhurnimet nga udhëzuesit e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve (FNK) dhe është prezantuar pyetësi hulumtues dhe rezultatet e tij nga Komuniteti për Edukim Profesional (PULSAR EduCop), zhvillimet kyçe si dhe plani i vitit 2021.

Bashkëpunimi i ShKÇAK dhe Global DCA

ShKÇAK ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Shoqatën Globale të Aseteve Digjitale dhe Kriptovalutave (Global DCA).



Global DCA është një shoqatë globale vetërregulluese për industrinë e asetëve digjitale dhe kriptovalutave. Paraqitja e asetëve digjitale, kriptovalutave dhe teknologjisë “blockchain” është duke transformuar me shpejtësi sistemin monetar global.

ShKÇAK dhe Global DCA së bashku do të angazhohen në dialog për çështjet kyçe në temën e asetëve digjitale, financave të decentralizuara dhe temave të tjera të ngjashme si dhe zhvillojnë aktivitete të përbashkëta duke përfshirë konferenca, uebinar, dhe hulumtime.

Në kuadër të MOU dhe për njoftim sa më të holësishëm për anëtarët dhe publikun është organizuar në bashkëpunim me Global DCA uebinari «Blockchain & Asetet Digjitale – Pozicionimi i Kosovës në Ekonominë Globale Digjitale».


Panelistë/ekspertë të fushës diskutuan rreth temës dhe përparësit unike që ofrohen nga teknologjia blockchain e që më parë ishin të paimagjinueshme: regjistrat kryesorë që janë të pandryshueshëm dhe transparent përmes përdorimit të decentralizimit dhe kriptografisë.

I ndërtuar si një sistem regjistri, nuk është çudi që teknologjia blockchain po hedh me shpejtësi një konfuzion në industrinë e kontabilitetit dhe financave. Asetet digjitale (kriptoalutat) - më e zakonshme prej të cilave është Bitcoin - po përdoren gjithnjë e më shumë në të gjithë botën. Bizneset e drejtpërdrejta dhe ato periferike që lehtësojnë hapësirën e asetëve digjitale ofrojnë mundësi të konsiderueshme për zhvillimin e biznesit, Investimet e Huaja Direkte (IHD), dhe krijimin e vendeve të punës për ekonomitë që përvetësojnë epokën digjitale.



Përderisa vendet si Kosova përparojnë dhe synojnë rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë Covid-19 dhe transformim afatgjatë – ky sesion është krijuar për të siguruar një pasqyrë të gjerë dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve kryesore si:

- Çfarë është Teknologjia Blockchain? Si lidhet me të gjitha risitë rreth aseteve digjitale?
- Cila është gjendja aktuale e industrisë së aseteve digjitale globalisht? Si po angazhohet Kosova tashmë në këtë hapësirë, krahasuar me vendet e tjera?
- Cilat janë mundësitë dhe sfidat e Kosovës për ekonominë digjitale?



Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë gjatë këtij viti edhe në uebinarin me temën: “Transformimi i industrisë së kriptovalutave dhe ekosistemi i aseteve digjitale” të organizuar nga Global DCA.

Qëllimi i uebinarit ishte që të informonte pjesëmarrësit mbi trendet dhe temat e ndryshme që ndërlihen me ekonominë digjitale. Gjatë uebinarit gjithashtu u diskutuan tre çështjet kyçe me të cilat përballet industria e kriptovalutave sot, siç janë:

- Standardet e industrisë;
- Rregullorja dhe raportimi;
- Ndikimi në mjedis dhe qëndrueshmëria;


Bashkëpunimi i ShKÇAK dhe Cactus Education

ShKÇAK dhe Cactus Education nënshkruan memorandum bashkëpunimi i cili ka për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e trajnimeve dhe zhvillimeve profesionale me fokus të theksuar në ngritjen e kapaciteteve drejt transformimit dhe zhvillimit digjital të profesionit.



ShKÇAK dhe Cactus Education së bashku do të angazhohen në shkëmbimin e njohurive dhe shkathtësive nëpërmjet bashkëpunimeve, të tilla si takime, konferenca, simpoziume dhe forma të tjera të bashkëpunimit institucional.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK



--- Raportim

→ Mbikëqyrje

STUDENTËT E VITIT 2021

ShKÇAK në vazhdimësi vlerëson përkushtimin që tregojnë anëtarët e Shoqatës gjatë ndjekjes së programeve çertifikuese. Edhe për vitin 2021 edhe pse një vit mjaftë sfidues edhe për studentët tanë, janë ndarë çmimet për Studentët e vitit si mirënjohje për rezultatet e arritura nga këta studentë, por edhe si inkurajim për studentët e tjerë për të vazhduar me përkushtimin e tyre drejt përfundimit të thirrjeve profesionale që ata i aspirojnë.

NIVELI “AUDITOR I ÇERTIFIKUAR”

Mirsad Suliqi



NIVELI “AUDITOR I BRENDSHËM I ÇERTIFIKUAR”

Egzon Osmani



NIVELI “KONTABILIST I ÇERTIFIKUAR”

Erleta Xhemajli



NIVELI “TEKNIK I KONTABILITETIT”

Gresa Xhema

SPECIALIZIMI “ EKSPERT I LICENCUAR I FORENZIKËS FINANCIARE”

*Donjeta Ahmeti
Gjeneta Ajazaj*



RAPORTET E KOMISIONEVE

Komisionet e ShKÇAK-së janë shtylla të rëndësishme në qeverisjen e Shoqatës dhe luajnë rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës dhe përmbushjen e objektivave të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

Komisionet e Shoqatës i përcjellin zhvillimet në fushat përkatëse të profesionit në vend dhe në botë dhe angazhohen që objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës t'i reflektojnë ato zhvillime në shërbim të interesit publik. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të avancuar të punës për kontabilistët dhe auditorët.

Në anën tjetër, Komisionet e ShKÇAK-së përkujdesen për ruajtjen e integritetit profesional të anëtarëve, respektimin e Kodit të Etikës nga ata dhe pajtueshmërinë e punës së tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të edukimit.



KOMISIONI PËR NOMINIME



RAPORT NGA KOMISIONI PËR NOMINIME

Të nderuar anëtarë,

Përfaqësimi juaj në strukturat e Shoqatës dhe pjesëmarrja në aktivitetet e ndryshme që zhvillohen përgjatë vitit, informimi me kohë dhe mbi të gjitha zëri i secilit prej jush bëhet i mundur përmes anëtarëve për të cilët ju votoni. Është e drejtë e juaja ekskluzive që të zgjedhni përfaqësuesit tuaj, e drejtë kjo të cilën e keni arritur me punën dhe angazhimin tuaj të palodhshëm për vite me radhë.

Nominimi i numrit sa më të madh të anëtarëve është me peshë të madhe për arsye se krijohet mundësia e përfshirjes sa më të madhe të anëtarëve në këtë proces e me këtë edhe mundësia më e madhe e zgjedhjes, prandaj Komisioni për nominime do të vazhdoj të ju inkurajoj që të nominoni anëtarët, kolegët tuaj për të cilët mendoni se mund të kontribuojnë në shtyrjen përpara të proceseve dhe zhvillimeve të Shoqatës. Për këtë arsye është miratuar rregullorja e re ku është përfshirë e drejta për të nominuar edhe auditorët e brendshëm të çertifikuar në mënyrë që të kemi përfshirje sa më të madhe të anëtarëve. Vendimet kryesore që janë ndërmarrë në këtë vit është aprovimi i planit të punës për nominime 2021/2022 dhe aprovimi i ftesës dhe formularit për nominime.

Vitin e kaluar Komisioni për Nominime ka zhvilluar procedurat për nominimin e anëtarëve për Komisionet e ShKÇAK zgjedhja e të cilëve është në kompetencë të Bordit. Bordi i Shoqatës duke u mbështetur në Strategjinë e ShKÇAK e ka bërë ristrukturimin e komisioneve me qëllim të përfshirjes më të gjerë të anëtarëve në këto komisione. Në vijim të kësaj duke marrë parasysh se mandati i anëtarëve të komisioneve ka skaduar në muajin janar 2021, Komisioni për nominime ka shpallur ftesën vitin e kaluar për nominime. Në lidhje me numrin e nominimeve të dërguara gjatë afatit të përcaktuar, Komisioni u nda i pakënaqur me numrin e të nominuarve përkundër shtyerjes së afatit për nominime.

Konform rregullores së Komisionit, anëtarëve të nominuar u janë dërguar pyetësorët dhe pas përfundimit të afatit për dorëzimin e tyre është proceduar me intervistimin dhe përfundimisht me prezantimin e rekomandimeve në Bordin e Shoqatës. Si rrjedhojë janë perzgjedhur anëtarët e komisioneve të mëposhtme:

- Komisioni për Auditorë Ligjor
- Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar
- Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale
- Komisioni për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standarde
- Komisioni për Tatime

Përveq procesit të zhvilluar për zgjedhjen e këtyre komisioneve, gjatë vitit 2021, Komisioni për Nominime konform Statutit dhe akteve normative ka zhvilluar procesin e nominimit për anëtarë të Bordit, anëtarë të Komisionit për nominime dhe anëtarë të Komisionit për sjellje dhe disiplinë, zgjedhja e të cilëve do të bëhet përmes votës suaj në Mbledhjen e Kuvendit të anëtarëve në vitin 2022.

Duke e konsideruar këtë proces të rëndësishëm tejet të madhe për Shoqatën, Komisioni për nominime është përkujdesur që i tërë procesi i nominimeve që nga faza fillestare që është shpallja e ftesës për nominime e deri tek përgatitja e prezantimit të rekomandimeve për Mbledhjen e Kuvendit, t'i respektoj të gjitha dispozitat e Statutit dhe të Rregullores së re të Komisionit të miratuar në muajin nëntor 2021. Në këtë drejtim Komisioni do të kujdeset që i tërë procesi të përfundojë brenda afatit të përcaktuar me Rregullore.

Fakt inkurajues në këtë proces të nominimeve është se numri i nominimeve respektivisht i anëtarëve të nominuar nga ju është i nivelit të kënaqshëm dhe mundëson zhvillimin e papenguar të procesit të mëtejshëm. Presim që ky proces i rëndësishëm të përfundojë me sukses në vitin 2022 edhe përkundër sfidave të cilat janë paraqitur në vazhdimësi si pasojë e pandemisë COVID-19.

Të nderuar anëtarë, jo vetëm në këto organe të Shoqatës por edhe në të gjitha organet tjera është shprehur vullneti juaj i lirë, dëshira juaj që të arrihen objektivat e përcaktuara dhe qëllimi i përbashkët që t'i ruajmë dhe avancojmë vlerat e arritura me përkushtim të madh dhe etikë profesionale.

Shpresa Mustafa

Kryesuese e Komisionit

KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË



RAPORTI NGA KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë gjatë vitit 2021 ka përmbushur me sukses detyrat dhe ka ushtruar përgjegjësitë e tij në bazë të Rregullores së brendshme të punës dhe Statutit të organizatës. Njëherësh ka qenë në shërbim të anëtarëve duke përcjellë në vazhdimësi punën e tyre profesionale, ka organizuar aktivitete në shërbim të anëtarëve të rinj dhe ka nxjerrë dokumente informimi e udhëzimi për etikën profesionale. Përtej sfidave në ushtrimin e përditshëm të profesionit dhe situatës me pandeminë, Komisioni ka përmbushur pritjet e tij të planit të punës për çka edhe është mandatuar.

Rrjedhimisht, gjatë vitit 2021 Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë ka mbajtur dy seanca disiplinore për shqyrtim të shkeljeve disiplinore të përcaktuar me Statut dhe Rregullore të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë. Mbi bazën e gjetjeve dhe dëshmive, Komisioni ka marrë vendim mbështetur në rregulloren e brendshme duke konstatuar shkelje të rëndë të etikës profesionale për çka edhe ka marrë masa. Si rezultat, i duhet kushtuar një vëmendje edhe më e madhe në vitin 2022 zbatimit të “Deklaratës së Betimit”. Të gjithë anëtarët duhet t’iu përmbahen parimeve që janë aty.

Krahas monitorimit të vazhdueshëm të performancës profesionale dhe etike të punës së anëtarëve, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë ka ndjekur edhe një agjendë proaktive me aktivitete në funksion të forcimit edhe më të madh profesional të anëtarëve. Ligjëratat e organizuar me anëtarët e rinj kanë pasur për qëllim ndarjen e mësimave, përvojave dhe njohurive më të fundit sa i përket etikës profesionale, legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira në vendet e tjera. Vijueshmëria dhe pjesëmarrja aktive në diskutime e anëtarëve të rinj ka qenë shumë e kënaqshme duke krijuar një pasqyrë reale për nevojat e shoqatës sonë.

Gjatë vitit 2021 është realizuar edhe një pyetësor për të gjithë anëtarët, për të vlerësuar zbatimin e parimeve themelore: objektivitetit, kompetencës profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale të anëtarëve në organizatat ku punojnë. Gjetjet e këtij pyetësori, përfundimet dhe rekomandimet janë shumë të nevojshme për të organizuar edhe më tutje punën tonë profesionale në shërbim të avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të anëtarëve tanë dhe kriimin e një ambienti më të mirë mes tyre dhe punëdhënësve. Shkurtimeisht, 78% e anëtarëve të anketuar janë të angazhuar në sektor privat, 16% e tyre në sektor publik ndërsa 6% në OJQ. Nga të anketuarit, 98% e anëtarëve besojnë se është e rëndësishme sjellja profesionale në përputhje me parimet e Kodit të Etikës në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit dhe që parimet e Kodit të Etikës të BSNEK/ IESBA (Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Auditor dhe Kontabilist) janë të rëndësishme për t’u aplikuar në përditshmëri.

Rreth 70% e ndërmarrjeve tek të cilat anëtarët e shoqatës janë të punësuar posedojnë Kod të Etikës, ndërsa 30% e tyre nuk kanë Kod të Etikës të aprovuar/ shkruar. Këto ndërmarrje mbështeten në besimin se të punësuarit e tyre do të veprojnë në mënyrë profesionale. Ndërsa 53% e të anketuarve mendojnë se rëndësia e sjelljes profesionale në përputhje me parimet e Kodit të Etikës së BSNEK-së varet nga pozita e punës (p.sh. Drejtor Ekzekutiv, Drejtor Financiar, Anëtarë Bordi etj.)

Në pyetjen se a keni pasur presion gjatë 12 muajve të fundit për të shkelur ndonjëherë nga parimet e Kodit të Etikës, 91% e të anketuarve kanë deklaruar që nuk kanë pasur presion, ndërsa 9% e tyre po.

Gjatë vitit 2021 kemi botuar dhe Broshurën që tregon në mënyrë të përmbledhur çka është etika; kush përcakton parimet e etikës për Auditorë dhe Kontabilistë dhe çka nënkuptojmë me parimet e Kodit të Etikës të BSNEK-së? Aty janë përmbledhur edhe aspekte të tjera si të veprohet në rast të kërcënimeve, ku ta raportohet e deri tek mbrojtja ndaj tyre.

Si kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë i vlerësoj të përmbushura synimet dhe pritjet tona gjatë vitit 2021 në aspekt të përfaqësimit sa më të mirë të anëtarëve; ngritjes profesionale të vazhdueshme të tyre; fuqizimin e rëndësisë së aplikimit të etikës profesionale dhe nxjerrjen e materialeve që kanë për qëllim informimin sa më të mirë për të drejtat e anëtarëve. Anketimi gjatë vitit 2021 me anëtarët ka nxjerrë të dhëna shumë të rëndësishme të cilat do të mirë përdoren për të rritur edhe më tej punën profesionale, aplikimin e etikës dhe përmirësuar përgatitjen e tyre profesionale. Secili anëtar duhet të udhëhiqet nga parimet e larta të etikës profesionale duke forcuar edhe më shumë imazhin e Shoqatës sonë, të Auditorit dhe Kontabilistit të Çertifikuar për çka ne të gjithë duhet të angazhohemi pa dallim.

Kaltrina Kadriu Xhemaj

Kryesuese e Komisionit



Nga e majta:
Elvira Ibrahim Hoti, Kaltrina Kadriu Xhemaj, Nekibe Haziri, Alban Lufi.

KOMISIONI PËR AUDITORË LIGJOR



RAPORTI NGA KOMISIONI PËR AUDITORË LIGJOR

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për Auditorë Ligjor ka për synim që të avokojë dhe përfaqësojë interesat e Auditorëve Ligjor anëtarë të ShKÇAK. Qëllimi ynë është që të sigurojmë që interesat e Auditorëve Ligjor të jenë të përfaqësuara me dinjitet duke siguruar si kundërvlerë shërbime cilësore dhe të plota në përputhje me interesat e publikut dhe standardet përkatëse ndërkombetare. Duke qenë anëtarë të ShKÇAK, Auditorët Ligjor duhet të reflektojnë në çdo moment gjatë punës së tyre etikën dhe standardet më të larta profesionale. Për të siguruar që jemi në përputhje me këto parime ne duhet të sigurohemi që korniza ligjore si dhe zbatimi i ligjeve në Kosovë të jetë në përputhje me këto kërkesa. Gjatë punës sonë si Komision ne jemi angazhuar në çështje si Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP), me c'rast kemi propozuar që të bëhen anketa të shpeshta për të parë nevojën e auditorëve për Edukim të Vazhdueshëm. Në të njejtën kohë kemi propozuar edhe vlerësimin e ligjëruesve në mënyrë që të jetë frytëdhënëse për trajnimet e ardhshme. Propozimi i jonë është që të pranohen edhe orët e EVP-ve jashtë ShKÇAK të cilat mund të konfirmohen dhe për të cilat mund të merret certifikata përkatëse. Në këtë kuadër kemi dhënë edhe propozimin tonë për kompetencat dhe EVP-të përkatëse të cilat do të pranoheshin nga ShKÇAK.

Një fushë në të cilën do të donim të avokonim është çështja e ndryshimit të kohës së dorëzimit të pasqyrave financiare të audituara në Këshillin Kosovar për Raprotim Financiar (KKRF). Për këtë aktivitet do e organizojmë një anketë për të parë qëndrimin e Auditorëve Ligjor. Çështje për të cilën duhet diskutuar dhe avokuar gjithashtu është çështja e tarifave të cilat paguhen nga auditorët gjatë procesit të rilicencimit, sepse është një përshtypje se kjo tarifë nuk reflekton shërbimin përkatës që Auditorët Ligjor pranojnë nga KKRF. Një çështje e cila vazhdon të brengosë komunitetin e Auditorëve Ligjor janë tarifat e auditorëve për shërbimet e dhëna dhe se shumë herë janë raportuar tarifa shumë të ulëta të cilat nuk sigurojnë auditim sipas standardeve përkatëse, zgjidhja e vetme për këtë çështje është ngritja e kapaciteteve si nga ShKÇAK ashtu edhe nga KKRF për Kontrollë të Cilësisë. Në këtë drejtim propozohet që fokus i vecant të jenë ato auditime të cilat përzgjedhen me tender sipas cmimit më të ulët.

Gjatë vitit 2022 ne do të vazhdojmë që të angazhohemi në të gjitha këto fusha të ngritura mirëpo do të shohim edhe në drejtime tjera për të parë se si mund të përmirësohet mjedisi i veprimit të Auditorëve Ligjor në Kosovë.

Lekë Musa
Kryesues i Komisionit

KOMISIONI PËR KONTABILISTË TË ÇERTIFIKUAR



RAPORT NGA KOMISIONI PËR KONTABILISTË TË ÇERTIFIKUAR

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar ka për qëllim të siguroj që Kontabilistët e Çertifikuar të ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë profesionale në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar duke implementuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Ky është viti i parë që një komision i tillë është themeluar nga ShKÇAK, andaj edhe pse funksionon për një periudhë të shkurtër, Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar gjatë këtij viti ka realizuar disa aktivitete.

Duke marrë parasysh që përgjegjësia e Kontabilistëve të Çertifikuar është më e madhe me hyrjen në fuqi të ligjit për raportim financiar, Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar ka kërkuar nga ShKÇAK që disa tema të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) të cilat janë të rëndësishme për Kontabilistë të Çertifikuar të përsëriten dhe poashtu të shtohen disa të reja, të cilat ndihmojnë Kontabilistët e Çertifikuar në përgatitje të pasqyrave financiare dhe në raportim.

Poashtu gjatë këtij viti është rishikuar dhe është plotësuar forma e përvojës praktike, e cila do të dërgohet si mostër të studentët të cilët kanë përfunduar provimet e programit për Kontabilistë të Çertifikuar.

Gjatë vitit 2022, komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar do të zhvilloj shumë aktivitete, por do të fokusohet në promovimin e rolit të kontabilistëve.

Arbëresha Tuhina

Kryesuese e Komisionit



Nga e majta:
Arbëresha Tuhina, Blerim Haliti, Fitore Meka

KOMISIONI PËR EDUKIM DHE STANDARDE PROFESIONALE



RAPORT NGA KOMISIONI PËR EDUKIM DHE STANDARDE PROFESIONALE

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale (KESP) gjatë vitit 2021, bazuar në strategjinë e përgjithshme të ShKÇAK është angazhuar në një numër aktivitete.

Gjatë vitit është rishikuar programi certifikues i ShKÇAK dhe është propozuar ndryshimi i lëndës P12/ Praktika profesionale me lëndën Menaxhimi strategjik i biznesit që do të zhvillohet gjatë vitit 2022 dhe do të implementohet nga viti 2023. Ky ndryshim në planprogram është bërë duke konsideruar zhvillimet aktuale në profesionin tonë dhe me qëllim të përgatitjes së studentëve me kompetenca përkatëse.

Gjithashtu komisioni në bashkëpunim me departamentin e edukimit dhe standardeve të ShKÇAK ka theksuar nevojën e vazhdueshme për zhvillimin e kompetencave në fushën e teknologjisë informative. Aktualisht programi certifikues i ShKÇAK ka tema të kufizuara në këtë fushë, prandaj KESP ka propozuar të adresohen këto tema në module të ndryshme të lëndës ekzistuese P8 /Menaxhimi i performancës.

Për ndryshimet e propozuara do të caktohet periudha kohore e zhvillimit të tyre dhe data tentative e fillimit të zbatimit në planprogram, duke konsideruar informimin me kohë të të gjithë anëtarëve/ studentëve.

Në fushën e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), komisioni ka konsideruar nevojën që të përcaktohen temat e obligueshme që secili anëtar duhet të ndjekë gjatë vitit dhe numrin e caktuar të orëve. Ky propozim bazohet në kërkesën që anëtarët të pajisen me njohuri të vazhdueshme për fushat e rëndësishme në punën e tyre praktike siç është raportimi financiar dhe auditimi duke iu kufizuar mundësinë që përmbushjen e orëve të EVP ta bëjnë me tema që mund të mos jenë relevante për punën e tyre.

Gjatë vitit, gjithashtu janë diskutuar kërkesat aktuale të përvojës praktike dhe komisioni do të adresojë këto çështje dhe do të propozoj ri-hartimin e kërkesave për përvojë praktike duke u bazuar në përvojat më të mira globale edhe nga organizatat tjera profesionale.

Digjitalizimi në rritje i proceseve biznesore ka paraqitur nevojën për njohuri specifike nga fusha e teknologjisë informative nga anëtarët e ShKÇAK. Njohja dhe vlerësimi i këtyre sistemeve dhe proceseve të digjitalizuara është pjesë përbërëse punës së përditshme nga auditorët dhe kontabilistët.

Aktualisht numri i auditorëve të TI është i limituar në Kosovë, prandaj KESP dhe zyra ekzekutive kanë paraqitur idenë e zhvillimit të mundshëm të një certifikimi të tillë. Ky propozim është në fazën fillestare dhe kërkohet përfshirje më e gjërë e komisioneve tjera, Bordit dhe organizatave tjera të specializuara në TI për të vlerësuar mundësinë e ofrimit të këtij program.

Lulzim Zeka

Kryesues i Komisionit



Nga e majta:
Edona Perjuci, Lulzim Zeka, Drita Kadriu Berisha

KOMISIONI PËR MENAXHIMIN TË CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET



RAPORT NGA KOMISIONI PËR MENAXHIMIN TË CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET

Të nderuar anëtarë,

Viti 2021 ishte vit i fokusimit në digjitalizimin e procesit të raportimit vjetor të anëtarëve të Shoqatës. Këtë vit për herë të parë, anëtarët e shoqatës, Auditor Ligjor, Auditor/ Kontabilist të certifikuar dhe Auditor të Brendshëm të certifikuar, kanë raportuar aktivitetet vjetore përmes platformës elektronike të raportimit të zhvilluar nga shoqata.

Ky vit gjithashtu shënon vitin e parë për përfshirjen në menaxhim të cilësisë të anëtarëve Auditor/ Kontabilist të certifikuar dhe Auditor të Brendshëm të certifikuar. Andaj janë krijuar letrat e punës për rishikim të angazhimeve të përgatitjes dhe nënshkrimit të setit të plotë të pasqyrave financiare. Letrat e punës janë përgatitur në përputhje me kërkesat bazë për shpalesje të SNRF për NVM, si dhe SNRF dhe SNK të plota.

Pas një raportimi të suksesshëm të aktiviteteve vjetore nga anëtarët, Komisioni për MCPS ka aprovuar përzgjedhjen e Auditorëve Ligjor dhe Auditorëve/Kontabilistëve të certifikuar për rishikim për pajtueshmëri me standardet profesionale.

Janë rishikuar për pajtueshmëri me standardet anëtarët të cilët mbajnë thirrjen profesionale Auditorëve/ Kontabilistëve të certifikuar dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet janë komunikuar dhe shqyrtuar me anëtarë. Gjatë këtij viti komisioni për MCPS ka aprovuar të gjitha Raportet e vlerësimit. Rezultatet e këtij rishikimi për pajtueshmëri me standardet treguan që paraqitja e përgjithshme e pasqyrave financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave kontabël, informacionet shpjeguese dhe shpalesjet janë mesatarisht në pajtueshmëri me standardet dhe ka nevojë të theksuar për përmirësim.

Poashtu, gjatë këtij viti është publikuar Hulumtimi për Cilësisë e Pasqyrave Financiare të Audituar të Ndërmarrjeve në Kosovë për vitet raportuese 2017, 2018 dhe 2019. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë që niveli i cilësisë së raportit të auditorit dhe pasqyrave financiare të audituar të ndërmarrjeve në Kosovë, përkundër përmirësimeve të identifikuara gjatë viteve të fundit, ka ende hapësirë për përmirësim. Pajtueshmëria e raportit të auditorit me SNA-të përkatëse, dhe pajtueshmëria e pasqyrave financiare me SNRF/SNK-të përkatëse sjellin transparencë, duke rritur krahasueshmërinë dhe cilësinë e informacionit financiar dhe duke ju mundësuar investitorëve të marrin vendime ekonomike të informuara. Rezultatet e këtij hulumtimi duhet të shërbejnë si sinjalizues për organet shtetërore që të ndërmerren hapa konkret për funksionalizimin e sistemit të mbikëqyrjes publike.

Në fund, me lejon të falënderoj të gjithë anëtarët e përzgjedhur për menaxhim të cilësisë, për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e treguar për ngritjen e cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit, gjithashtu Departamentin e menaxhimit të cilësisë për pajtueshmëri me standardet (DMCPS) për punën e realizuar gjatë këtij viti sfidues, duke kontribuar kështu në realizimin e misionit të ShKÇAK-së për mbrojtje të interesit publik.

Mentor Hyseni

Kryesues i Komisionit

KOMISIONI PËR TATIME



RAPORTI NGA KOMISIONI PËR TATIME

Të nderuar Anëtarë,

Komisioni i Tatimeve gjatë vitit 2021, ka vepruar në pajtim me Rregulloren e Komisionit për Tatime të aprovuar nga Brodi i SHKÇAK, me Planin e punës si dhe në pajtim me kërkesat nga palët e interesit. Fillimisht Komisioni për Tatime dhanë propozimet e veta për planin e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP) për 2021, përfshirë EVP-në për deklaratimet vjetore në të ardhura personale dhe atyre të korporatave.

Duke marrë parasysh se Pandemia COVID-19 dhe masat kufizuese vazhduan edhe gjatë vitit 2021, Komisioni për Tatime ishte angazhuar në debatet e organizuara online nga Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT) me palë të treta rreth gjendjes së politikave dhe sistemit tatimor. Duke mbrojtur interesin publik dhe të anëtarësisë e të bizneseve kemi dhënë propozime më qëllim lehtësimi dhe stimulimi tatimor si dhe administrim më të lehtë tatimor për tatimpagues. Duke marrë për bazë Vendimin e Qeverisë lidhur me faljen e ndëshkimeve, Komisioni për Tatime përgatiti një shkresë për Aministratën Tatimore të Kosovës (ATK) lidhur me sqarimin rreth trajtimit të ndëshkimeve si objekt i faljes, duke mos u pajtuar me përgjigjen e ATK, Shoqata së bashku me Odën Amerikane kanë dërguar shkresë edhe te Kryeministri i Republikës së Kosovës në fund të shkurtit 2021, duke mos marrë përgjigje.

Komisioni për Tatime ka qenë aktiv gjatë iniciativës nga MFT për rishikimin e politikave tatimore me qëllim të hartimit të «Dokumentit për rishikim të politikave tatimore», përmes diskutimit publik rreth ndryshimit të politikave fiskale dhe sistemit tatimor në vendin tonë.

Si Komision për Tatime pranë Shoqatës, jemi ftuar nga Departamenti i Politikave Fiskale dhe Tregjeve Financiare pranë MFT, për të dhënë rekomandime lidhur me kapërcimin e situatës nga Pandemia COVID-19 dhe ate duke u fokusuar në: 1) Masat për Rimbëmbje ekonomike si pasojë e Pandemisë COVID-19 , që mund të zgjasë më gjatë se një vit; 2) Komentet dhe propozimet rreth përmirësimit të sistemit tatimor në Kosovë. Komisioni për këtë qëllim iu kishte drejtuar anëtarësisë së gjerë të SHKÇAK për të dhënë propozime. Në takimin e parë të Komisionit me anëtarë të ri, janë marrë vendime dhe janë propozuar masa rreth lehtësimit tatimor gjatë kohës së Pandemisë duke marrë parasysh edhe propozime nga anëtarësia e gjerë rreth ndryshimit të politikave tatimore.

Një prej propozimeve nga SHKÇAK dhe Oda Ekonomike Amerikane janë përcjell në MFT që kanë të bëjnë me reformë të sistemit tatimor sidomos gjatë pandemisë si:

- lejimi i aplikimit të normës 0% të tvsh për aktivitete të caktuara dhe deklarimi tremujor i tvsh;
- pagesa e paradhënjeve të tatimit në fitim TAK dhe TAP të bëhet bazuar me metodën e parashikimit;

- aplikimi i metodës së përshpejtuar të zhvlerësimit;
- zgjatja e afatit të faljes së ndëshkimeve;
- lehtësimi i pjesëshëm i obligimeve tatimore në të ardhura dhe kontribute pensionale për bizneset e afektuara;
- heqja e ndëshkimeve për përdorimin e metodës “streha e sigurtë” në rastin e kontrollit dhe tejkalimit të detyrimeve mbi 20%;
- stimulimi i bizneseve me rastin e punësimit të punësuarve të rinjë;
- zgjerimi i fushëveprimit për lejime të veçanta.

Komisioni për Tatime në Planin e punës për vitin 2021 kishte paraparë edhe çështjen e monitorimit të zbatimit të Planit për përmirësimin e Integritetit të ATK-së. Ky plan paraprakisht ishte diskutuar gjatë me palët e interesit përfshirë pjesëmarrjen e Komisionit për Tatime të ShKÇAK, duke dhënë edhe propozime shumë prej të cilave ishin bërë pjesë e këtij plani. Nga pikat që parashiheshin të zbatoheshin në Planin e Integritetit të ATK-së të publikuara, Komisioni ka monitoruar këtë zbatim të Planit dhe ka konstatuar se përveç angazhimeve nga ATK në lehtësim të qasjes sa më të shpejtë për zbatim të masave qeveritare sa i përket pandemisë, në disa fusha nuk është përmbush zotimi nga Plani i përmirësimit të Integritetit të paraqitura në Shtyllën IV pikën 4.1 Rritja e shërbimeve elektronike me afat realizimi deri më 31.03.2021 si:

- Kërkesa për hapje apo mbyllje të llogarive tatimore;
- Kërkesa për çregjistrim nga TVSH;
- Kërkesa për transfer Debi-Kredi;
- Kërkesa për Certifikatë të Rezidencës;
- Njoftim për transfer të Biznesit;
- Kërkesa për tatuarje në të ardhura reale;
- Kërkesa për rimbursim të kontributeve pensionale për të vetë-punësuarit;
- Kërkesa për rimbursim të kontributeve pensionale për punëdhënësin;
- Njoftim për hedhjen apo shkatërrimin e mallrave të dala jashtë përdorimit.

Përveç plasimit të deklaratës WR në mënyrë online përmes sistemit EDI të paraparë në pikën 4.2.1 të Planit e cila ishte përmbush deri më 31.03.2021 si dhe ndërrimin e informatave mbi tatimpaguesin përfshirë ndërrimin e adresës, në Planin e Integritetit ishte paraparë që nën pikën 4.2.2 Avancimi i sistemit elektronik EDI, për mundësinë e gjenerimit të gjendjes së përgjithshme të tatimpaguesit të bëhet deri më 31.08.2021. Kjo ende nuk është arritur. Një lehtësim për tatimpaguesit ishte arritur që përmes sistemit elektronik të ATK-së të dorëzohen edhe Pasqyrat Financiare sipas kërkesave të KKRF-së dhe ATK-së.

Komisionit për Tatime ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e Komitetit Tatimor në Odën Ekonomike Amerikane, duke dhënë propozime rreth ndryshimit të politikave tatimore në Kosovë.

Shoqata dhe Komisioni për Tatime si gjithëherë bashkëpunimin e ka vazhduar edhe me Oda të tjera në Kosovë përfshirë edhe pjesëmarrjen në takime me Odën Gjermano- Kosovare lidhur me Politikën Fiskale dhe ato të administrimit të tatimeve. Janë përcjellë me kohë të gjitha propozimet e komisionit dhe anëtarësisë pranë kësaj Ode me qëllim bashkërenditje të veprimeve në ndryshim të politikave nga Qeveria dhe zbatimit të atyre në fuqi sa më drejtë nga ATK por edhe nga Dogana.

Presim që ShKÇAK, Komisionit për Tatime dhe anëtarëve tanë, si faktor të rëndësishëm në këtë profesion t'iu mundësohet nga institucionet vendimarrëse një rol shumë më domethënës në bërjen e politikave qeveritare për të qenë një mbrojtës i interesit publik përfshirë edhe interesin ekonomik të komunitetit biznesor përmes lehtësimeve të procedurave tatimore dhe atyre biznesore në përgjithësi.

Fahri Breznica


Kryesues i Komisionit



Nga e majta:
Blerim Pushkolli, Fahri Breznica, Shyqiri Bytyqi

Shërbimet që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK-së

Në grafikun në vijim është paraqitur shpërndarjen e shërbimeve nga anëtarët tanë nëpër sektorë të ndryshëm, sidomos dallohen shërbimet e auditimit, shërbimet kontabël, këshillimet për tatime, mbajtja e librave kontabël dhe të tjera të ngjashme të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është e domosdoshme në mënyrë që profesionistët të mbulojnë tërë sektorin privat dhe publik.




Rezultatet tregojnë se 36% e anëtarëve janë të punësuar në kategorinë Industri/Tregti, ndërkaj 18% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, 30% e tyre janë partnerë apo punonjës në firma të auditimit dhe kontabilitetit dhe 15% e anëtarëve janë të angazhuar në sektorë të tjerë.

Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve tanë janë po ashtu të përfshirë në sektorin Akademi/Edukim, përkatësisht 1% e tyre. Ky përfaqësim ndihmon në përafrimin e kurrikulumeve të kontabilitetit dhe auditimit në mes të edukimit akademik dhe profesional sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet (SNEK).

Studentët e regjistruar gjatë vitit 2021

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve të ri të cilët janë regjistruar në programet çertifikuese të ShKÇAK.




Gjatë vitit 2021 janë regjistruar në nivelin para kualifikues Teknik i Kontabilitetit 274 studentë. Specifikisht, 171 studentë janë regjistruar në programin për nivelin kualifikues “Kontabilist i Çertifikuar”, dhe 41 studentë janë regjistruar në programin për të marrë titullin “Auditor i Çertifikuar”.

Titujt e fituar përgjatë viteve

ShKÇAK i jep studentëve dhe anëtarëve mundësi mjaft të mëdha për t'u treguar të suksesshëm duke ofruar tre afate të provimeve gjatë një viti. Në këtë mënyrë edhe atëherë kur studentët dhe anëtarët nuk arrijnë suksesin e dëshiruar gjatë një afati mund të përgatiten dhe të kenë mundësinë t'i nënshtrohen provimeve një apo dy afate më vonë.


Statistikat e ShKÇAK flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve të çertifikuar nga viti 2019-2021, në të tre nivelet e çertifikimeve, ku vërehet një interesim i shtuar për pjesëmarrje në nivelin Teknik të Kontabilitetit, Kontabilist të Çertifikuar dhe Auditorë të Çertifikuar.



Programi Auditor i Brendshëm i Çertifikuar

Programi specializues për Auditim të Brendshëm ka filluar në vitin 2017 si një specializim i ri shumë nevojshëm dhe i dobishëm si për sektorin privat ashtu dhe për sektorin publik.


Sipas grafikut të mëposhtëm për periudhën 2017-2021 kemi të regjistruar 207 studentë nga të cilët 90 prej tyre kanë fituar thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar dhe mund të ofrojnë ekspertizën e tyre në fushën e Auditimit të Brendshëm si në sektorin publik ashtu dhe në sektorin privat.



Pjesëmarrja në profesion sipas gjinisë

Tradicionalisht, profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka qenë i përfaqësuar nga gjinia mashkullore si në botë ashtu edhe në vend. Megjithatë, në kohët e fundit ka pasur një ndryshim për të mirë në këtë drejtim pasi që ka vazhduar të rritet numri i ushtrueseve gra të këtij profesioni. Kjo e përforcon faktin që gratë në Kosovë po emancipohen dita ditës më shumë.


Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë vitit 2021, përqindja e anëtareve femra te Shoqatës ka qenë 52.4%, ndërsa e anëtarëve meshkuj ka qenë 47.6%. Kështu, krahasuar me vitin 2002 ku pjesëmarrja e femrave si anëtare të shoqatës ka qenë vetëm 14%, viti 2021 vazhdon të mbajë pjesëmarrjen e femrave në epërsi.



Pjesëmarrja në ligjëratat përmes platformës virtuale

Ligjërimi përmes platformës virtuale ishte paraqitur si mundësi e vetme gjatë pandemisë Covid 19. Në grafitin e mëposhtëm janë paraqitur përgjigjet e studentëve/anëtarëve të anketuar lidhur me përshtatshmërinë e platformës së përdorur (ZOOM) për ligjëratat.

Siç shihet dhe në grafikun e mëposhtëm 23% e studentëve/anëtarëve janë shprehur se platforma ka qenë jashtëzakonisht e përshtatshme, 31% janë shprehur se platforma ZOOM ka qenë shumë e përshtatshme, , 28% janë shprehur se platforma ka qenë mesatarisht e përshtatshme, 12% janë shprehur se kjo platform ka qenë paksa e përshtatshme ndërsa 6% janë shprehur se kjo platform nuk është aspak .



IN MEMORIAM



RIFAT HOXHA

1985 – 2021

Kontabilist i çertifikuar



ARBEN DERMAKU

1976 – 2021

Teknik i kontabilitetit



SHAHE SHALA BERISHA

1961 – 2021


Auditore ligjore



BAHTIJAR BERISHA

1963 – 2021

Auditor ligjor



SHKUMBIN BICAJ

1971 – 2021

Kontabilist i çertifikuar



Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar
dhe Auditorëve të Kosovës

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të pavarur
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2021



Përmbajtja:

| | |
|--|---|
| Raporti i auditorëve të pavarur..... | 3 |
| Pasqyra e pozitës financiare | 5 |
| Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse | 6 |
| Pasqyra e ndryshimeve në fonde | 7 |
| Pasqyra e rrjedhës së parashë | 8 |
| Shënimet e pasqyrave financiare..... | 9 |



Raport i Auditorit të Pavarur
Drejtuar: Këshillit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës**, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2021, si dhe Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Fonde, Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të **Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës** më 31 Dhjetor 2021, dhe rezultatit e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Raportim Financiar për NVM.

Baza për Opin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmëri në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritët të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticismin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.



- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Astrit
 Astrit Musa – Audit & Consulting Associates
 ACA – Audit & Consulting Associates
 Prishtinë, Kosovë
 08 Shkurt 2022



PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**Me 31 dhjetor 2021***Të gjitha shumat në Euro*

| | Shënimet | 2021 Euro | 2020 Euro |
|---|----------|----------------|----------------|
| PASURITË | | | |
| Pasuritë jo-qarkulluese | | | |
| Prona, impiantet dhe pajisjet | 3 | 26,491 | 25,142 |
| Pasuritë e paprekshme | 4 | 1,370 | 9,452 |
| | | 27,861 | 34,594 |
| Pasuritë qarkulluese | | | |
| Stoqet -librat | | 5,859 | 4,446 |
| Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera | 5 | 23,153 | 21,793 |
| Paraja dhe ekuivalentet e parasë | 6 | 618,572 | 517,165 |
| | | 647,584 | 543,404 |
| TOTAL PASURITË | | 675,445 | 577,998 |
| FONDET DHE DETYRIMET | | | |
| Fondet | | | |
| Teprica e akumuluar e të hyrave | | 514,337 | 441,753 |
| Fondi i përgjithshëm | | 514,337 | 441,753 |
| DETYRIMET | | | |
| Detyrimet afat-gjata | | | |
| Huat që bartin interes | 7 | - | 2,593 |
| | | - | 2,593 |
| Detyrimet afat-shkurta | | | |
| Huat që bartin interes | 7 | 2,593 | 7,674 |
| Llogari të pagueshme dhe detyrime tjera | 8 | 15,599 | 19,940 |
| Të hyrat e shtyra | 9 | 142,916 | 106,038 |
| | | 161,108 | 133,652 |
| TOTAL DETYRIMET | | 161,108 | 136,245 |
| TOTAL FONDET DHE DETYRIMET | | 675,445 | 577,998 |


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i SHKÇAK më 27 Janar 2022 dhe janë nënshkruar nga:

Rina Sejdiu - Mustafa

Zyrtare për Financa


Shpresa Mustafa

Kryetare e Bordit



Shënimet shpjeguese nga faqe 9 në faqe 20 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021
Të gjitha shumat në Euro

| | Shënimet | 2021 Euro | 2020 Euro |
|-----------------------------------|----------|------------------|------------------|
| Të hyrat operative | | | |
| Të hyrat nga edukimi | 10 | 325,750 | 344,285 |
| Të hyrat nga anëtarësimi | 10 | 117,154 | 122,067 |
| Të hyrat nga kontrolli i cilësisë | 10 | 23,050 | 11,600 |
| Të hyrat nga Dep Konsulencës | 10 | 8,900 | |
| Të hyra tjera | 10 | 10,180 | 27,044 |
| Totali i të hyrave | | 485,034 | 504,996 |
| Shpenzimet | | | |
| Shpenzimet e administrative | 11 | (174,505) | (170,403) |
| Shpenzimet e trajnimit | 12 | (93,529) | (110,234) |
| Shpenzimet e provimeve | 13 | (19,409) | (29,438) |
| Shërbimi për anëtarë | 14 | (104,258) | (94,376) |
| Shpenzimet e Dep Konsulencës | 15 | (20,749) | - |
| Shpenzimet tjera | 16 | - | (13,990) |
| Totali i shpenzimeve | | (412,450) | (418,441) |
| Teprica e të hyrave | | 72,584 | 86,555 |

Shënimet shpjeguese nga faqe 9 në faqe 20 janë pjesë integrale e këtyre pasqyrave financiare

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE FONDE
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021
Të gjitha shumat në Euro

| | Me 31 dhjetor 2021 | Me 31 dhjetor 2020 |
|--|-----------------------|-----------------------|
| Më 01 janar | 441,753 | 355,198 |
| Ndryshime të tjera në tepricën e akumuluar | | |
| Teprica e të hyrave për vitin | 72,584 | 86,555 |
| Teprica e akumuluar e të hyrave me 31 dhjetor | 514,337 | 441,753 |

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021
Të gjitha shumat në Euro

| | Shënim | 2021 Euro | 2020 Euro |
|---|----------|----------------|----------------|
| AKTIVITETET OPERATIVE | | | |
| Teprica e të hyrave të vitit | | 72,584 | 86,555 |
| Zhvlërimi dhe amortizimi | 3.4 | 12,823 | 15,011 |
| Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera | | (1,360) | 1,416 |
| Stoqet | | (1,413) | (1,233) |
| Të pagueshmet tregtare dhe të tjera | | (4,341) | 6,224 |
| Të hyrat e shtyra | | 36,878 | (27,981) |
| Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative | | 115,171 | 79,992 |
| AKTIVITETET INVESTUESE | | | |
| Blerja e pronës, implantëve dhe pajisjeve | | (6,090) | (1,765) |
| Blerja e pasurisë së paprekshme | | | (4,026) |
| Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese | | (6,090) | (5,791) |
| AKTIVITETET FINANCUESE | | | |
| Pagesat e kredisë | | (7,674) | (7,523) |
| Paraja neto e përdorur në aktivitete financuese | | (7,674) | (7,523) |
| Rrjedha neto e parasë për periudhën | | 101,407 | 66,678 |
| Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim | | 517,165 | 450,487 |
| PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË NË FUND | 9 | 618,572 | 517,165 |

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2021

Të gjitha shumat në Euro

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (“SHKÇAK” ose “Organizata”) është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.06/L- 043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

- Profesionalizmit të Ndërsjellë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;
- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2021 dhe 2020, Organizata ka kryer aktivitetet me 12 dhe 16 të punësuar përkatësisht.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2021 dhe 2020. Të dhënat aktuale dhe krahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.5 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.6 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza

neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrëmin në të njëjtën kohë.

2.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njih të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

- Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar fatura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.
- Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranuar për paradhënie.

2.8 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribuueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlerësimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e pamcaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

2.9 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

| | 2021 | 2020 |
|-----------------------------|----------|----------|
| Mobiljet dhe paisjet | 2-5 vite | 2-5 vite |
| Paisjet e TI nën 1,000 Euro | 3 vite | 3 vite |
| Veturat | 5 vite | 5 vite |

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njeja përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës pëmbajnë Softuerë kompjuterik, të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave dhe licence nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.11 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shumat e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet në mënyrë që të

përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e hudhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe rrisin specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregullurara.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënie e rivlerësimit. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë nëshkuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.12 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime koston përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstrukttoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me koston, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.13 Lizingu

Lizingu klasifikohet si lizing financiar sa herë që transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë të dhënë me qira ndaj Kompanisë. Të gjitha kontratat e tjera janë klasifikuar si lizing operativ.

Të drejtat për pasuritë e mbajtura si lizing financiar njihen si pasuri të Organizatës në vlerën e drejtë të pronës së dhënë me lizing (ose, në qoftë se vlera është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të lizingut) në fillimin e lizingut. Detyrimi që korrespondon me qiradhënësin është përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim i lizingut financiar. Pagesat e lizingut ndahen mes të pjesës financiare dhe uljes së detyrimit të lizingut në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit në bilancin e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare zbriten gjatë kalkulimit të fitimit ose humbjes. Pasuritë e mbajtura me lizing financiar janë të përfshira në kuadër të zërit prona, pajisjet dhe impiantet, të cilat zhvlerësohen dhe vlerësohen për dëmtim (humbje nga rënia në vlerë) në të njëjtën mënyrë si pasuritë e tjera në pronësi.

Lizingu i pagueshëm operativ ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë afatit të kontratës së lizingut.

2.14 Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet koston dhe çmimit të shitjes minus koston e kompletimit

dhe shitjes.

2.15 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arkëtueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Në fund të çdo penudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.16 Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.17 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

2.18 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.19 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.20 Tatimi në fitim

SHKÇAK është knjuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2021 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuni të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2021, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.21 Gjykimet kritike dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të SHKÇAK, të cilat janë përshkruar në shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasuive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të identifikueshme nga burimet tjera.

Covid-19 pandemia

Zhvillimi i shpejtë i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik në Kosovë dhe globalisht mund të rezultojë në supozime dhe vlerësime që kërkojnë nshikime të cilat mund të sjellin rregullime në vlerën kontabël

të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Në veçanti, menaxhmenti pret që supozimet dhe vlerësimet e përdorura në përcaktimin e të arkëtueshmeve tjera, huazimeve, të pagueshmeve tregtare dhe të tjera dhe vlerat e tyre mbajtëse të mos ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, SHKÇAK vazhdon të përmbushë detyrimet e saj që lidhen me detyrime financiare brenda periudhës kur duhet të shlyhen dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimisë gjatë përgatitjes së këtyre pasqyrave.

3 Prona, impiantet dhe pajisjet

| | Kompjuterët dhe pajisjet tjera | Automjeti | Total |
|-----------------------------------|-----------------------------------|-----------------|-----------------|
| | Euro | Euro | Euro |
| Kosto | | | |
| Më 01 janar 2020 | 73,431 | 29,700 | 103,131 |
| Shtesat gjatë vitit | 1,765 | - | 1,765 |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2020 | 75,196 | 29,700 | 104,896 |
| Më 01 janar 2021 | 75,196 | 29,700 | 104,896 |
| Shtesat gjatë vitit | 6,090 | - | 6,090 |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2021 | 81,286 | 29,700 | 110,986 |
| Zhvlrësimi i akumuluar | | | |
| Më 01 janar 2020 | (67,667) | (5,940) | (73,607) |
| Zhvlrësimi i vitit | (3,177) | (2,970) | (6,147) |
| Zhvlrësimi për heqjet gjatë vitit | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2020 | (70,844) | (8,910) | (79,754) |
| Më 01 janar 2021 | (70,844) | (8,910) | (79,754) |
| Zhvlrësimi i vitit | (1,771) | (2,970) | (4,741) |
| Zhvlrësimi për heqjet gjatë vitit | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2021 | (72,615) | (11,880) | (84,495) |
| Vlera neto në libra | | | |
| Më 31 dhjetor 2020 | 4,352 | 20,790 | 25,142 |
| Më 31 dhjetor 2021 | 8,671 | 17,820 | 26,491 |

4 Pasuritë e patrupëzuara

| | Softuerë komputërik | Të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave | Licenca nga autoriteti Kombetar i Kualifikimeve | Total |
|-----------------------------------|------------------------|--|--|-----------------|
| | Euro | Euro | Euro | Euro |
| Kosto | | | | |
| Më 01 janar 2020 | 42,465 | 32,275 | 6,928 | 81,668 |
| Shtesat gjatë vitit | - | - | 4,026 | 4,026 |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2020 | 42,465 | 32,275 | 10,954 | 85,694 |
| Më 01 janar 2021 | 42,465 | 32,275 | 10,954 | 85,694 |
| Shtesat gjatë vitit | - | - | - | - |
| Heqjet gjatë vitit | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2021 | 42,465 | 32,275 | 10,954 | 85,694 |
| Amortizimi i akumuluar | | | | |
| Më 01 janar 2020 | (41,866) | (19,365) | (6,147) | (67,378) |
| Amortizimi i vitit | (285) | (6,455) | (2,123) | (8,863) |
| Amortizimi për heqjet gjatë vitit | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2019 | (42,151) | (25,820) | (8,270) | (76,241) |
| Më 01 janar 2021 | (42,151) | (25,820) | (8,270) | (76,241) |
| Amortizimi i vitit | (285) | (6,455) | (1,342) | (8,082) |
| Amortizimi për heqjet gjatë vitit | - | - | - | - |
| Më 31 dhjetor 2021 | (42,437) | (32,275) | (9,612) | (84,324) |
| Vlera neto në libra | | | | |
| Më 31 dhjetor 2020 | 314 | 6,455 | 2,684 | 9,452 |
| Më 31 dhjetor 2021 | 29 | 0 | 1,341 | 1,370 |

5 Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmet tjera

| | 2021 Euro | 2020 Euro |
|--|---------------|---------------|
| <i>Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera</i> | | |
| Të arkëtueshmet nga anëtarët | 12,965 | 13,990 |
| Minus: Lejimi për borxhet e dyshimta nga anëtarët | (1,297) | (1,399) |
| | 11,668 | 12,591 |
| <i>Të arkëtueshmet tjera</i> | | |
| Parapagimet -E drejta për shfrytëzimin e materialeve nga BPP learning Media (ACCA License Fee) | 11,485 | 9,202 |
| Të arkëtueshmet tjera | - | - |
| | 11,485 | 9,202 |
| Total të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera | 23,153 | 21,793 |

| 6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë | 2021 | 2020 |
|---------------------------------------|----------------|----------------|
| | Euro | Euro |
| Paraja në arkë | - | - |
| Paraja në bankë | 368,572 | 267,165 |
| Depozitat afatshkurtëra të afatizuara | 250,000 | 250,000 |
| Gjithsej | 618,572 | 517,165 |

| 7 Hua që bartin interes | 2021 | 2020 |
|---|--------------|---------------|
| | Euro | Euro |
| Hua nga institucionet financiare lokale | 2,593 | 10,267 |
| Pjesa qarkulluese | 2,593 | 7,674 |
| Pjesa jo qarkulluese | - | 2,593 |
| Gjithsej | 2,593 | 10,267 |

| 8 Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet të tjera | 2021 | 2020 |
|---|---------------|---------------|
| | Euro | Euro |
| Llogaritë e pagueshme | | |
| Furnitorët | 430 | 263 |
| Detyrimet tjera | | |
| Detyrimet për kontribute dhe tatime të mbajtura të të ardhurave personale mbi pagat | 10,457 | 8,244 |
| Detyrimet për shërbime të auditimit | 2,950 | 2,891 |
| Të pagueshmet ndaj punonjësve | 300 | 316 |
| Shpenzimet akruale dhe të tjera | 1,462 | 8,226 |
| Gjithsej | 15,169 | 19,676 |

9 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2021, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

| | 2021 | 2020 |
|--------------------------------|----------------|----------------|
| | Euro | Euro |
| Më 1 janar | 106,038 | 134,019 |
| Inkasimet gjatë vitit | 251,178 | 224,633 |
| Të hyrat e njohura gjatë vitit | (214,300) | (252,614) |
| Gjithsej | 142,916 | 106,038 |

10 Të hyrat

| | 2021 | 2020 |
|--|----------------|----------------|
| | Euro | Euro |
| Të hyrat nga edukimi | | |
| Regjistrimi | 5,480 | 7,330 |
| Trajnimet- sektori privat | 199,410 | 184,276 |
| Provimet- sektori privat | 62,460 | 91,024 |
| Trajnimi-Auditimi i brendshëm | 12,920 | 22,810 |
| Provimet-Auditimi i brendshëm | 2,850 | 6,870 |
| Trajnimet per specializimet -Ekspert i lartë tatimor dhe Ekspert i Licensuar i Forenzikës financiare | 2,580 | 1,450 |
| Edukimi i vazhdueshëm profesional | 40,050 | 30,525 |
| Gjithsej të hyrat nga edukimi | 325,750 | 344,285 |
| Të hyrat nga anëtarësimi | 117,154 | 122,067 |
| Të hyrat nga kontrolli i cilësisë | 23,050 | 11,600 |
| Të hyrat nga Departamenti i konsulencës | 8,900 | - |
| Të hyrat e tjera | | |
| Të hyrat nga projekti me EBRD | - | 14,000 |
| Të hyrat nga EVP me ZKA | 4,700 | 6,155 |
| Të hyrat e tjera (nga interesi dhe riaktivizimet) | 5,480 | 6,888 |
| Gjithsej të hyrat tjera | 10,180 | 27,044 |
| Gjithsej të hyrat | 485,034 | 504,996 |

11 Shpenzimet administrative

| | 2021 Euro | 2020 Euro |
|---------------------------------|----------------|----------------|
| Pagat | 116,462 | 119,788 |
| Zhvlerësimi | 4,741 | 6,147 |
| Amortizimi | 8,082 | 8,863 |
| Qiraja | 10,080 | 10,440 |
| Shërbimet komunale | 2,604 | 2,743 |
| Shpenzime të komunikimit | 1,889 | 1,830 |
| Furnizime të zyrës | 3,089 | 2,640 |
| Shërbime të auditimit | 2,950 | 2,891 |
| Mirëmbajtje -renovim i zyrës | 498 | 297 |
| Sigurim shëndetësor | 2,408 | 2,537 |
| Shpenzimet e reprezentacionit | 1,081 | 2,093 |
| Shpenzimet e automjetit | 2,367 | 1,652 |
| Orendi dhe Paisje TI | 13,131 | 5,491 |
| Shpenzime tjera | 2,243 | 2,991 |
| Shpenzimet e borxheve të këqija | 2,880 | - |
| Gjithsej | 174,505 | 170,403 |

12 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2021 dhe 2020 ishin si në vazhdim:

| | 2021 Euro | 2020 Euro |
|---|---------------|----------------|
| Mbajtja e trajnimeve | 49,786 | 59,845 |
| Qiraja | 14,400 | 19,800 |
| Printimi | 6,313 | 7,355 |
| Spektori publik | - | - |
| Shpenzimet e rrymës | 688 | 1,326 |
| Të drejtat autoriale BPP, përkthimi dhe azhurnimi | 14,800 | 11,015 |
| Spektori i auditimit të brendshëm | 5,906 | 9,482 |
| Tjera | 1,636 | 1,411 |
| Gjithsej | 93,529 | 110,234 |

13 Shpenzimet e provimeve

| | 2021 | 2020 |
|-------------------------|---------------|---------------|
| Përpillimi & korrigjimi | 10,610 | 15,672 |
| Mbikëqyrja | 4,897 | 7,041 |
| Qiraja | 2,160 | 2,160 |
| Printimi | 1,706 | 3,356 |
| Te tjera | 36 | 1,210 |
| Gjithsej | 19,409 | 29,438 |

14 Shërbimi për anëtarë

| | 2021 | 2020 |
|--|----------------|---------------|
| Edukimi i vazhdueshëm profesional | 3,531 | 4,439 |
| Këshilli dhe komisionet | 9,681 | 6,300 |
| Udhëtimet | 1,956 | 5,093 |
| Takimet vjetore dhe ceremonitë | 3,832 | 1,626 |
| Anëtarësia në organizata | 14,623 | 15,306 |
| Seminare dhe punëtori | 118 | 23 |
| Pagat-shërbimi për anëtarë | 30,944 | 27,587 |
| Zhvillimi i certifikimeve tjera dhe KC | 31,110 | 30,147 |
| Marketingu | 1,448 | 464 |
| IT dhe Web-faqja | 2,958 | 2,945 |
| Të tjera | 4,057 | 446 |
| Gjithsej | 104,258 | 94,376 |

*Shpenzimet e Këshillit dhe Komisioneve përfshijnë kompensimet për takime.

15 Shpenzimet e departamentit të konsulencës

| | 2021 | 2020 |
|---------------------|---------------|----------|
| Shpenzimet e pagave | 20,749 | - |
| Gjithsej | 20,749 | - |

16 Shpenzimet tjera

| | 2021 | 2020 |
|-------------------------------------|----------|---------------|
| Shpenzimet lidhur me projekt - EBRD | - | 13,990 |
| Gjithsej | - | 13,990 |

17 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2021 përveç marrëveshjes së qirasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Paga mujore e qirasë për zyre dhe sala të trajnimeve është 2,600 Euro.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2021 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

18 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

| 9 Parapagimet | | 2018 | 2017 |
|---|---------------------------------------|------------------|-----------------|
| Parapagimet | | 8,839 | 5,629 |
| | | 8,839 | 5,629 |
| 10 Të arkëtueshmet | | 2018 | 2017 |
| Të arkëtueshmet nga anëtarët | | 5,164 | 4,085 |
| Minus: Provisionsi për të arkëtueshmet e këqia dhe të dyshimta nga anëtarët | | (516) | (409) |
| | | 4,647 | 3,676 |
| 11 Prona, impiantet dhe pajisjet | | | |
| | Kompjuterët dhe pajisjet tjera | Automjeti | Totali |
| KOSTO | | | |
| Më 01 janar 2017 | 62,971 | 12,666 | 75,637 |
| Shtesat gjatë vitit 2017 | 3,987 | - | 3,987 |
| Më 31 dhjetor 2017 | 66,958 | 12,666 | 79,624 |
| Më 01 janar 2018 | 66,958 | 12,666 | 79,624 |
| Shtesat gjatë vitit 2018 | 5,014 | 29,700 | 34,714 |
| Heqjet gjatë vitit 2018 | (1,239) | (12,666) | (13,905) |
| Më 31 dhjetor 2018 | 70,733 | 29,700 | 100,433 |
| Zhvlërësimi i akumuluar | | | |
| Më 01 janar 2017 | (56,937) | (12,666) | (69,603) |
| Zhvlërësimi i vitit 2017 | (4,094) | - | (4,094) |
| Më 31 dhjetor 2017 | (61,031) | (12,666) | (73,697) |
| Më 01 janar 2018 | (61,031) | (12,666) | (73,697) |
| Zhvlërësimi i vitit 2018 | (3,592) | (2,970) | (6,562) |
| Zhvlërësimi për heqjet gjatë vitit 2018 | 1,055 | 12,666 | 13,721 |
| Më 31 dhjetor 2018 | (63,567) | (2,970) | (66,537) |
| Vlera neto në libra | | | |
| Më 31 dhjetor 2017 | 5,927 | - | 5,927 |
| Më 31 dhjetor 2018 | 7,166 | 26,730 | 33,896 |

12 Pasuritë e patrupëzuara

| | Softuerë kompjuterik | Të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave | Licenca nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve | Totali |
|-------------------------------|-------------------------|--|--|-----------------|
| KOSTO | | | | |
| Më 01 janar 2017 | 41,038 | - | - | 41,038 |
| Shtesat gjatë vitit 2017 | 1,288 | 32,275 | 4,586 | 38,149 |
| Më 31 dhjetor 2017 | 42,326 | 32,275 | 4,586 | 79,187 |
| Më 01 janar 2018 | 42,326 | 32,275 | 4,586 | 79,187 |
| Shtesat gjatë vitit 2018 | 139 | - | 2,342 | 2,481 |
| Më 31 dhjetor 2018 | 42,465 | 32,275 | 6,928 | 81,668 |
| Amortizimi i akumuluar | | | | |
| Më 01 janar 2017 | (40,808) | - | - | (40,808) |
| Amortizimi i vitit 2017 | (487) | (6,455) | (1,529) | (8,471) |
| Më 31 dhjetor 2017 | (41,296) | (6,455) | (1,529) | (49,279) |
| Më 01 janar 2018 | (41,296) | (6,455) | (1,529) | (49,279) |
| Amortizimi i vitit 2018 | (285) | (6,455) | (2,309) | (9,050) |
| Më 31 dhjetor 2018 | (41,581) | (12,910) | (3,838) | (58,329) |
| Vlera neto në libra | | | | |
| Më 31 dhjetor 2017 | 1,031 | 25,820 | 3,057 | 29,908 |
| Më 31 dhjetor 2018 | 884 | 19,365 | 3,090 | 23,339 |

13 Detyrimet tregtare dhe të tjera

| | 2018 | 2017 |
|---|---------------|---------------|
| Detyrimet për kontributin e tatimit të të ardhurave personale mbi pagat | 8,122 | 7,365 |
| Detyrimet për shërbimet e auditimit | 3,927 | 2,652 |
| Të pagueshmet ndaj furnitorëve | 1,969 | 304 |
| Të pagueshme ndaj punonjësve | 353 | 216 |
| | 14,372 | 10,537 |

14 Të hyrat e shtyra

Analiza e balancës

Me 31 Dhjetor 2018, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

| | 2018 | 2017 |
|---|---------------|---------------|
| Tarifat e shtyra të edukimit dhe anëtarimit | 96,593 | 93,677 |
| Grantet e shtyra: | | |
| - Granti ICU-BQK | - | 50 |
| | 96,593 | 93,727 |

15 Zotimet dhe Kontingjentet**Zotimet**

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2018 përveç marrëveshjes së qirasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qirasë për zyre dhe salla të trajnimeve është 2,800 Euro.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2018 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

16 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalesje në pasqyrat financiare.

www.scaak.org

